

PRAPA EKRANEVE

Raport vjetor për gjendjen e çrregullimit
informativ

Korrik, 2024



HIBRIDO.INFO

Prapa Ekraneve

Raport vjetor për gjendjen e çrregullimit informativ

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, korrik 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit "Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit", që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



AUTOR:
Plator Avdiu

Kontrollues të fakteve:

Fatbardh Dema
Festim Rizanaj
Etrit Rexhepi
Endrit Berisha



Visit our website
www.hibrid.info



Na gjeni në Facebook
[@hibridinfo](https://www.facebook.com/hibridinfo)



Na gjeni në Twitter
[@hibridinfo](https://twitter.com/hibridinfo)



Na gjeni në Youtube
[@hibridinfo](https://www.youtube.com/@hibridinfo)



Na gjeni në LinkedIn
[@hibrid.info](https://www.linkedin.com/company/hibridinfo)

Zyrat tona:
Bulevardi Nënë Tereza,
Rruga "Hajdar Dushi" 22A/1,
Hyrja 9, Nr. 4,
Prishtinë, 10000
Kosovë
+383 (0) 49 165 164
info@hibrid.info

Përmbajtja

Hyrje	7
Metodologjia	15
Koncepti i çrregullimit informativ	17
Analizë e të dhënave monitoruese të çrregullimit informativ në Kosovë	19
Përmbledhje krahasuese e të dhënave të çrregullimit informativ në Kosovë ndërmjet dy periudhave vjetore	47
Praktika e keq(informimit)	52
Rregullimi i mediave në Kosovë	53
Rekomandime	55

Qëllimi i këtij raporti monitorues dhe analitik pasqyron gjendjen e çrregullimit informativ në Kosovë gjatë periudhës vjetore korrik 2023 – qershor 2024, bazuar në të dhënat e grumbulluara nga platforma për kontroll të fakteve “hibrid.info”.

Ky raport është i ideuar nga platforma “hibrid.info”, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Raporti synon të analizojë çrregullimin informativ në Kosovë përmes të dhënave empirike të siguruara nga aktivitetet monitoruese të platformës “hibrid.info” në baza ditore. Raporti përbëhet prej tri pjesëve kyçe:

- Pjesa e parë e raportit shqyrton dhe analizon në mënyrë shteruese të dhënat e monitorimit të periudhës njëvjeçare të çrregullimit informativ në Kosovë përmes matjeve të ndryshme në funksion të luftimit të çrregullimit informativ.
- Pjesa e dytë krahason të dhënat e monitorimit të kësaj periudhe vjetore (korrik 2023 – qershor 2024) me ato të periudhës paraprake vjetore (korrik 2022 – qershor 2023) në kategori e fusha të caktuara të çrregullimit informativ në Kosovë.
- Pjesa e fundit e këtij raporti trajton zhvillimet më të fundit lidhur me rregullimin e mediave në Kosovë, përfshirë ndryshime e fundit ligjore sa i përket rregullimit të mediave kosovare, përfshirë edhe mediat online.

Gjetjet kryesore të raportit

Gjatë kësaj periudhe vjetore (korrik 2023 – qershor 2024), të dhënat monitoruese të platformës “hibrid.info” për çrregullimin informativ në Kosovë tregojnë se publikues të ndryshëm kanë publikuar më së shumti artikuj në kategorinë vlerësuese “Clickbait”. Rreth 22% përqind e artikujve janë vlerësuar si “Clickbait” dhe në vendin e dytë janë përmbajtjet keqinformuese[1] të vlerësuara si “Dezinformatë” me 21%.

Sa i përket artikujve keqinformues “Clickbait”, ato janë publikuar dhe shpërndarë më së shumti në fushën e kronikës së zezë dhe temave sociale që nxisin kureshtjen e lexuesve për të klikuar në publikime të tilla. Të gjithë artikujt në këtë kategori vlerësimi janë publikuar në gjuhën shqipe, përkatësisht mediat reale në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti artikuj me përmbajtje të tillë prej 83% gjithsej, kurse publikues të tjerë dukshëm më pak, siç janë publikues të ndryshëm në Facebook prej 11% dhe portale të dyshimta prej 6%.

Ndërkaq, përmbajtjet keqinformuese të vlerësuara si “Dezinformatë” më së shumti kanë trajtuar çështje politike dhe të sigurisë. Pjesa më e madhe e dezinformatave janë publikuar nga publikues në shqip prej 85%, duke përfshirë këtu publikuesit në media sociale, mediat reale dhe mediat e dyshimta. Sa i përket dezinformatave në shqip, shumica dërrmuese e tyre ose 61% janë krijuar e shpërndarë në mediat sociale, kryesisht nga faqe dhe llogari në Facebook dhe TikTok, kurse pjesa tjetër në përqindje dukshëm më të vogël nga mediat reale (12%) dhe ato të dyshimta (12%). Lidhur me dezinformatat e publikuara në gjuhën shqipe, publikuesit në mediat sociale, kryesisht faqe dhe llogari në Facebook dhe TikTok, kanë krijuar më së shumti përmbajtje keqinformuese për ngjarje të sigurisë dhe politikës, në të cilat mbizotëron pashmangshëm konflikti Izrael-Hamas, pasuar nga ngjarjet në veri të Kosovës për sulmin e terroristëve serbë në fshatin Banjskë të

Sa i përket dezinformatave në shqip, shumica dërrmuese e tyre ose 61% janë krijuar e shpërndarë në mediat sociale, kryesisht nga faqe dhe llogari në Facebook dhe TikTok, kurse pjesa tjetër në përqindje dukshëm më të vogël nga mediat reale (12%).

[1] Me përmbajtje keqinformuese, në këtë raport, nënkuptohen ato publikime që shpërndahen si informacion i pasaktë me tendencën të paraqiten si fakte, shtrembërime të fakteve, lajme të rreme dhe të paverifikuara, si dhe forma të ndryshme të shkeljes së postulateve themelore të mirinformimit që duhet të garantojnë informacion të pavarur, objektiv dhe të vërtetë për publikun.

Zveçanit kundër Policisë së Kosovës, shpërthime në veri, lufta në Ukrainë, armatosja e Forcës së Sigurisë së Kosovës etj. Kurse, mediat reale në gjuhën shqipe, ndonëse kanë publikuar më pak dezinformata, theksi i tyre ka qenë në fushën politike dhe të sigurisë me përmbajtje keqinformuese për veriun, vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës për dinarin serb etj. Mediat e dyshimta në shqip kanë trajtuar më tepër çështje sociale në kuadër të dezinformatave të shpërndara dhe më pak për çështje politike apo të sigurisë.

Nga ana tjetër, rreth 14% e dezinformatave të monitoruara përgjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë publikuar në gjuhën serbe. Pothuajse të gjitha prej tyre janë publikuar nga mediat reale në gjuhën serbe (12%) dhe një pjesë tjetër nga publikues në gjuhën serbe në mediat sociale (2%). Mediat reale në gjuhën serbe kanë publikuar dezinformata lidhur me ngjarjet në Kosovë për çështje politike e të sigurisë, të cilat trajtojnë më së shumti veriun e Kosovës për sulmin e organizuar terrorist serb në Banjskë dhe pretendimet e mediave në gjuhën serbe se Policia e Kosovës po terrorizon serbët në komunat veriore të Kosovës.

Dezinformatat e publikuara nga mediat reale në gjuhën serbe janë pjesë e narrativit serb për të keqinformuar lidhur me zhvillimet në Kosovë pa u bazuar në saktësim apo verifikim të fakteve dhe burimeve të informacionit me qëllim të dezinformimit për ngjarje për dhe rreth Kosovës.

Dezinformatat e publikuara nga mediat reale në gjuhën serbe janë pjesë e narrativit serb për të keqinformuar lidhur me zhvillimet në Kosovë pa u bazuar në saktësim apo verifikim të fakteve dhe burimeve të informacionit me qëllim të dezinformimit për ngjarje për dhe rreth Kosovës. Sipas njohësve të mediave në Kosovë, narrativi serb kundrejt Kosovës është i ngjashëm ose e kopjon narrativen ruse ndaj Ukrainës për ta kualifikuar Kosovën si “shtet të dështuar” dhe e cila shfrytëzohet nga mediat e afërta me pushtetin në Serbi për të krijuar dhe shpërndarë dezinformata të tilla kundër Kosovës.

Tema kryesore e keqinformimit gjatë kësaj periudhe ka qenë konflikti Izrael-Hamas. Kjo temë ka nxitur publikuesit në shqip, kryesisht faqe, llogari dhe media që operojnë në mediat sociale, që të krijojnë dhe shpërndajnë më së shumti artikuj me përmbajtje keqinformuese përgjatë kësaj periudhe. Për këtë konflikt të huaj janë publikuar rreth 10% e temave, kurse, rastet tragjike renditen në vendin e dytë me 6.5%, si dhe ngjarjet në veriun e Kosovës me 6.3% në vendin e tretë. Kjo është hera

e parë që veriu i Kosovës nuk është tema më e trajtuar nga publikuesit në përmbajtjet e tyre keqinformuese.

Pothuajse të gjithë artikujt keqinformues për konfliktin mes Izraelit dhe Hamasit janë publikuar në gjuhën shqipe (98%) dhe pothuajse në mënyrë absolute ose 96% e tyre janë publikuar dhe shpërndarë nga publikues në shqip në mediat sociale (91% në Facebook dhe 5% në TikTok). Në mënyrë më specifike ato janë publikuar kryesisht nga publikues në mediat sociale, publikimet e të cilëve konsiderohen si pro-islamike me përmbajtje në gjuhën shqipe. "Hibrid.info" ka gjetur se ky është konflikti i parë ndërkombëtar kur për herë të parë është përdorur inteligjenca artificiale për të sajuar imazhe me pretendimin se paraqet gjendjen e konfliktit mes Izraelit dhe Hamasit, por të cilat janë vlerësuar si përmbajtje keqinformuese. Lidhur me përmbajtjet keqinformuese për rastet tragjike, të gjitha prej tyre janë publikuar në shqip. Mediat reale në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti (84%) dhe pjesa tjetër, në përqindje më të vogël, nga publikues në mediat sociale (14%) dhe mediat e dyshimta (2%). Sa i përket veriut, shumica e publikimeve keqinformuese për këtë temë janë shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale prej 62%, në mediat reale 32% dhe mediat e dyshimta 6%. Pothuajse $\frac{3}{4}$ ose 74% e përmbajtjeve keqinformuese për veriun janë publikuar në shqip, prej të cilave dominojnë publikuesit në mediat sociale prej 52%, mediat reale 16% dhe mediat e dyshimta 6%. Për sa i përket publikimeve për veriun në gjuhë të tjera, 24% e tyre janë publikuar në gjuhën serbe, prej të cilave 16% në mediat reale dhe 8% nga publikuesit në mediat sociale. Ndërkaq, rreth 2% e artikujve keqinformues për veriun ishin publikuar në gjuhën angleze në mediat sociale.

Tema kryesore e keqinformimit gjatë kësaj periudhe ka qenë konflikti Izrael-Hamas. Kjo temë ka nxitur publikuesit në shqip, kryesisht faqe, llogari dhe media që operojnë në mediat sociale, që të krijojnë dhe shpërndajnë më së shumti artikuj me përmbajtje keqinformuese përgjatë kësaj periudhe.

Nga ana tjetër, fusha tematike mbi të cilën publikuesit e ndryshëm kanë prodhuar më së shumti përmbajtje keqinformuese është fusha e sigurisë me 27%, e cila pasohet nga përmbajtjet keqinformuese në fushën sociale me 23% dhe fusha politike me 22%. Këto janë tri fushat kryesore më të shpeshta të keqinformimit për këtë periudhë, ndërsa në

fushat tjera kishte më pak keqinformime, siç janë kronika e zezë me 14% dhe fusha tjera tematike prej 14% (si sporti, moti, ekonomia, shëndetësia etj.). Duket se arsyeja kryesore që ka dominuar fusha e sigurisë për këtë periudhë qëndron në faktin se më së shumti publikime keqinformuese ka pasur për konfliktin Izrael-Hamas nga publikuesit në gjuhën shqipe në mediat sociale. Përveç kësaj, mund të thuhet se siguria dhe politika kanë mbizotëruar më së shumti gjatë kësaj periudhe prej 49% të dyja së bashku në krahasim me kronikën e zezë dhe çështjet sociale që përbëjnë rreth 37% të të gjithë artikujve keqinformues për periudhën korrik 2023 – qershor 2024.

Shumica dërrmuese e publikimeve me përmbajtje keqinformuese për këtë periudhë vjetore janë krijuar dhe shpërndarë në mediat sociale nga publikues të ndryshëm në shqip.

Shumica dërrmuese e publikimeve me përmbajtje keqinformuese për këtë periudhë vjetore janë krijuar dhe shpërndarë në mediat sociale nga publikues të ndryshëm në shqip. Kjo është një nga gjetjet kryesore të këtij raporti monitorues sepse për herë të parë vërehet se ka më shumë përmbajtje keqinformuese të publikuara në mediat sociale se sa në mediat tjera. Në këtë mënyrë, 56% e publikimeve keqinformuese ishin publikuar nga publikues të ndryshëm në mediat sociale, 39% në mediat reale dhe vetëm 5% në media të dyshimta.

Gjatë kësaj periudhe vjetore, sa i përket mediave sociale, publikues të ndryshëm në Facebook, në gjuhën shqipe, kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues prej 38% gjithsej për tema jo vetëm për Kosovën, por edhe për zhvillime ndërkombëtare. Në vendin e dytë janë publikimet keqinformuese në TikTok me 14%, ndërsa mediat tjera sociale kanë dukshëm përqindje më të ulët prej 4% (Telegram, X, YouTube, Instagram dhe Reddit).

Publikuesit në mediat sociale kanë qenë të fokusuar kryesisht në krijim dhe shpërndarje të artikujve keqinformues në kategoritë e dezinformatës (14%) dhe lajmeve të rreme (14%), si dhe në përmbajtje të paverifikuara (11%) dhe mashtrim (10%). Në Facebook janë publikuar më shumë dezinformata dhe përmbajtje e paverifikuara, kurse në TikTok janë publikuar kryesisht lajme të rreme. Për më tepër, publikuesit në mediat sociale, ku pothuajse të gjithë prej tyre janë në gjuhën shqipe prej 98%, kanë publikuar artikuj keqinformues më së shumti në fushat e sigurisë (20%), sociale në vendin e dytë (14%) dhe politikës në të tretin

(11%). Siç u përmend më lartë, tema kryesore e keqinformimit nga publikuesit në mediat sociale ishte konflikti mes Izraelit dhe Hamasit. Rreth 96% e përmbajtjeve keqinformuese për këtë konflikt të huaj janë publikuar në mediat sociale, gjegjësisht 91% në Facebook dhe 5% në TikTok. Arsyet kryesore të monitorimit të artikujve keqinformues mbi konfliktin Izrael-Hamas janë se përmbajtjet mbi këtë temë kanë mbizotëruar mbi të gjitha temat tjera dhe se kjo temë ka pasur ndikim të madh, veçanërisht nga përdorues të ndryshëm në mediat sociale si temë që ka nxitur klikime dhe komente të shumta në Facebook dhe TikTok. Tema të tjera që ishin trajtuar nga publikuesit në mediat sociale përfshinë armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (7%), veriun e Kosovës (7%), dhënie të kredive (5%) etj.

Përkundrazi, mediat reale kanë publikuar më së shumti publikime keqinformuese në kategorinë "clickbait" prej 18% dhe kategoritë tjera ishin më pak të pranishme, si dezinformatat me 5% dhe teoritë konspirative me 5%. Mediat reale kanë publikuar kryesisht përmbajtje keqinformuese për politikë (11%), kronikë të zezë (10%), pasuar nga temat sociale (7%) dhe siguria (6%). Tema më e trajtuar nga mediat reale ishin rastet tragjike me 13%, pasuar nga raportime keqinformuese për vdekje me 5% dhe veriu me 5%, po ashtu. Gjithashtu, prej të gjitha publikimeve keqinformuese nga mediat reale, 81% e tyre ishin publikuar nga mediat reale në shqip dhe 18% nga mediat reale në gjuhën serbe. Në kuadër të mediave reale në gjuhën shqipe dominojnë në masë të madhe përmbajtje keqinformuese në kategorinë "clickbait" duke lënë shumë mbrapa kategoritë tjera (gabim, përmbajtje të paverifikuara, dezinformata etj.), kurse tek mediat në gjuhën serbe prijnë keqinformatat në kategoritë e teorisë konspirative dhe dezinformatat në ndërlidhje me ngjarje rreth Kosovës.

Kurse, mediat e dyshimta kanë publikuar kryesisht dezinformata (3%), ndonëse ky lloj i publikuesve kanë publikuar dukshëm më pak në krahasim me publikuesit tjerë (mediat sociale dhe mediat reale). Ato kanë shpërndarë kryesisht artikuj keqinformues për çështjet sociale (2%).

Institucionet më të përfolura nga artikujt keqinformues janë institucionet kosovare të sigurisë, si Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës lidhur me ngjarje që ndërlidhen me këto institucione të sektorit të sigurisë gjatë kësaj periudhe vjetore. Kurse, personaliteti më i përfolur është kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në kuadër të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm për zhvillime kryesisht në fushën politike dhe të sigurisë në Kosovë.

CLICKBAIT (22%)	Temat	
	Raste tragjike	24.3%
	Vdekje	9.6%
	Tërmete	3.4%
	Vrasje	3.4%
	Të tjera	59.3%
DEZINFORMATË (21%)	Temat	
	Konflikti Izrael-Hamas	14.1%
	Veriu	11.2%
	Lufta në Ukrainë	4.1%
	Punë në Zvicër	3.5%
	Të tjera	67.1%
LAJM I RREMË (15%)	Temat	
	Armatosja e FSK-së	20.0%
	Konflikti Izrael-Hamas	6.7%
	Veriu	5.8%
	Pajisja e FSK-së	5.0%
	Të tjera	62.5%
PËRMBAJTJE E PAVERIFIKUAR (14%)	Temat	
	Konflikti Izrael-Hamas	32.7%
	Veriu	9.7%
	Sulmi i Iranit ndaj Izraelit	5.3%
	Armatosja e FSK-së	4.4%
	Të tjera	47.9%
MASHTRIM (10%)	Temat	
	Dhënie të kredive	25.9%
	Produkte shëruese	11.8%
	Lojë shpërblyese	5.9%
	Konflikti Izrael-Hamas	2.4%
	Të tjera	54.0%
TEORI KONSPIRATIVE (5%)	Temat	
	Vendbanimet me shumicë serbe	40.0%
	Veriu	10.0%
	Kërcënim me luftë	5.0%
	Të tjera	45.0%

Fushat		Llojet e publikuesve		Llojet e mediave sociale		Gjuha	
Kronikë e zezë	44.6%	Media reale	83.0%	Facebook	11.1%	Shqip	100.0%
Sociale	22.6%	Media sociale	11.1%				
Politika	14.7%	Media të dyshimta	5.9%				
Siguri	5.1%						
Të tjera	13.0%						
Fushat		Llojet e publikuesve		Llojet e mediave sociale		Gjuha	
Siguri	37.3%	Media sociale	63.5%	Facebook	46.5%	Shqip	85.3%
Politika	29.0%	Media reale	24.1%	TikTok	14.7%	Serbisht	13.5%
Sociale	17.2%	Media të dyshimta	12.4%	X (ish-Twitter)	1.2%	Anglisht	1.2%
Sport	5.9%			Mediat tjera sociale	1.1%		
Të tjera	10.6%						
Fushat		Llojet e publikuesve		Llojet e mediave sociale		Gjuha	
Siguri	47.5%	Media Sociale	95.0%	TikTok	50.8%	Shqip	97.5%
Politika	26.7%	Media reale	2.5%	Facebook	39.2%	Serbisht	2.5%
Sociale	10.0%	Media të dyshimta	2.5%	Telegram	2.5%		
Kronikë e zezë	8.3%			YouTube	2.5%		
Të tjera	7.5%						
Fushat		Llojet e publikuesve		Llojet e mediave sociale		Gjuha	
Siguri	44.2%	Media sociale	77.0%	Facebook	66.4%	Shqip	93.8%
Sociale	23.9%	Media reale	23.0%	TikTok	5.3%	Serbisht	3.5%
Sport	11.5%			Telegram	1.8%	Anglisht	2.7%
Politika	10.6%			Mediat tjera sociale	3.5%		
Të tjera	9.8%						
Fushat		Llojet e publikuesve		Llojet e mediave sociale		Gjuha	
Sociale	58.8%	Media sociale	91.8%	Facebook	67.1%	Shqip	97.6%
Politikë	17.6%	Media të dyshimta	5.9%	TikTok	22.4%	Anglisht	2.4%
Ekonomi	9.4%	SMS	2.3%	X (ish-Twitter)	2.3%		
Siguri	4.7%						
Të tjera	9.5%						
Fushat		Llojet e publikuesve		Llojet e mediave sociale		Gjuha	
Siguri	37.5%	Media reale	77.5%	Facebook	10.0%	Serbisht	75.0%
Politikë	32.5%	Mediat Sociale	22.5%	TikTok	5.0%	Shqip	25.0%
Sociale	22.5%			Instagram	2.5%		
Të tjera	7.5%			Telegram	2.5%		
				Twitter	2.5%		

Metodologjia

Ky raport është hartuar duke përdorur kryesisht metodat kuantitative si të dhëna empirike sa i përket monitorimit të çrregullimit informativ në Kosovë, por edhe metoda kualitative për pjesë të caktuara të raportit.

Në pjesën kuantitative janë përdorur të dhënat e monitorimit ditore të mbledhura nga ekipi monitorues i platformës “hibrid.info” në bazë të aktiviteteve ditore. Përgjatë kësaj periudhe vjetore të monitorimit të çrregullimit informativ, “hibrid.info” ka monitoruar 818 artikuj me përmbajtje keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe dhe gjuhët tjera (gjuhët serbe dhe angleze). Ky numër i artikujve shërben si mostër përfaqësuese për analizimin e të dhënave të monitorimit në këtë raport, për të cilat “hibrid.info” ka bërë kontroll rigoroz të fakteve dhe janë publikuar në platformë në baza ditore me një mostër prej mesatarisht 3 artikujve të trajtuar në ditë. Në këtë raport janë kryqëzuar të dhënat duke bërë krahasime mes kategorive të ndryshme të çrregullimit informativ për ta bërë më të kuptueshme trendin e keqinformimit në Kosovë dhe identifikimin e sfidave në drejtim të luftimit të çrregullimit informativ, si një nga prioritetet kryesore të platformës “hibrid.info”.

Në bazë të kriterëve metodologjike, publikuesit që monitorohen nga “hibrid.info” përfshinë mediat reale (portalet informative), portalet e dyshimta dhe mediat sociale, duke u bazuar në këto klasifikime:

- Mediat reale (portalet informative) që janë të regjistruara si entitete dhe si veprimtari kanë informimin e publikut.
- Portale të dyshimta të cilat në faqet e tyre nuk japin të dhëna rreth veprimtarisë së tyre, por që në praktikë publikojnë informacione të ndryshme që në shumicën e rasteve pretendojnë të paraqiten si media.
- Mediat sociale: llogari, faqe, faqe zyrtare, profile në mediat sociale si: Facebook, X (ish-Twitter), TikTok, Telegram etj.

Përzgjedhja e përmbajtjeve keqinformuese, të cilat gjenerojnë çrregullimin informativ në Kosovë dhe që monitorohen nga “hibrid.info” bëhet sipas këtyre tri kriterëve kryesore:

- Rëndësia e përmbajtjes duke u fokusuar në rëndësinë e informacionit dhe përfshirjen e personave në informacionin e shpërndarë.
- Ndikimi që mund të ketë përmbajtja tek audiencia për shkak të rëndësisë politike, socio-ekonomike etj.
- Viraliteti apo rrjedha shpërndarëse e përmbajtjes duke përfshirë mediat reale, portalet e dyshimta dhe mediat sociale.

Sa i përket gjuhës së përmbajtjeve keqinformuese, "hibrid.info" monitoron përmbajtjet e publikuara kryesisht në media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale që prodhojnë e shpërndajnë përmbajtje në shqip, por edhe përmbajtjet në gjuhë tjera që ndërlidhen me Kosovën dhe zhvillimet përreth saj që kanë një ndërlidhje të konteksti më të gjerë, e që publikohen në media reale dhe media sociale. Në këtë rast, tek publikimet në gjuhën serbe monitorohen kryesisht mediat reale dhe në një përqindje më të vogël publikuesit në mediat sociale (ku kryesisht dominon Telegram) që shpërndajnë përmbajtje keqinformuese në gjuhën serbe lidhur me Kosovën. Megjithatë, përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe mbizotërojnë më së shumti dhe këto dy mostra (në gjuhën shqipe dhe atë serbe) nuk janë të krahasueshme mes vete sepse, prej të gjitha përmbajtjeve keqinformuese të monitoruara nga platforma "hibrid.info" për këtë periudhë vjetore, 91% e tyre janë në gjuhën shqipe dhe 8% e tyre në gjuhën serbe, ndërkaq rreth 1% në gjuhën angleze.

Pos burimeve në media, në platformë përdoren edhe burime tjera, si profilet në rrjete sociale të figurave publike e politike të cilët krijojnë opinion publik.

Ndërsa, të dhënat kualitative janë marrë nga diskutimet në grupin e fokusit me ekspertë të mediave, redaktorë dhe gazetarë me përvojë që ishte organizuar në muajin qershor 2024. Kësaj i ka paraprirë edhe një punë hulumtuese përmes analizimit, shqyrtimit dhe konsultimit të kornizës ligjore në Kosovë për mediat, si dhe analizën e diskursit publik lidhur me rregullimin e mediave në Kosovë. Po ashtu, edhe arkivat e mediave në Kosovë kanë shërbyer si një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport monitorues dhe hulumtues.

Në funksion të shmangies së keqinterpretimeve të disa nocioneve teknike/profesionale të përdorura në raport, sidomos sa i përket kategorive vlerësuese të çrregullimit informativ dhe llojeve të publikueseve të përmbajtjeve keqinformuese, raporti ka ofruar shpjegimin praktik e konkret të këtyre nocioneve në kuadër të seksionit me titull "Fjalorthi".

I. KONCEPTI I ÇRREGULLIMIT INFORMATIV

Çrregullimi informativ, si nocion gjithëpërfshirës për keqinformimin, dezinformimin dhe lajmet e rreme, në literaturën profesionale dhe akademike, për herë të parë u përmend dhe u përkufizua si koncept nga autorët Claire Wardle dhe Hossein Derakhshan në një raport të botuar nga Këshilli i Evropës më 2017. Sipas tyre, çrregullimi informativ në vetvete manifestohet përmes tri formave kryesore: keqinformimit, dezinformimit dhe çinformimit (me qëllim për të shkaktuar dëm),[2] siç përmbledhen në vijim:

KEQINFORMIMI

Shpërndarja e informacionit të rremë që nuk nënkupton se është i dëmshëm patjetër

DEZINFORMIMI

Shpërndarja e informacionit të rremë në mënyrë të qëllimshme për të shkaktuar dëm

ÇINFORMIMI

Shpërndarja e informacionit të vërtetë për të shkaktuar dëm, shpeshherë duke transferuar informacionet private në sferën publike

Hulumtimet në rrafshin teorik, profesional dhe akademik të këtij fenomeni u vunë në qendër të vëmendjes, me theks të veçantë pas fushatës së referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për largim nga Bashkimi Evropian (i njohur ndryshe si Brexit) në qershor 2016 dhe fushatës së zgjedhjeve presidenciale në SHBA më 2016. Në këto dy ngjarje me rëndësi evropiane dhe globale u shpërndanë në masë të madhe lajme të rreme dhe dezinformata nga akterë të ndryshëm për qëllime manipulimi, përfshirë edhe nga ndikime të jashtme që shpeshherë i referohen si ndërhyrje nga ana e Rusisë[3] për të ndërhyrë ose ndikuar në ngjarje me peshë të madhe në atë kohë.

[2] Wardle, C., & Derakhshan, H. (2017). Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policymaking, f. 5. Strasbourg: Council of Europe.

[3] Conrad, M., & Hålfdanarson, G. (2023). Introduction: Europe in the Age of Post-Truth Politics. In M. Conrad, G. Hålfdanarson, A. Michailidou, C. Galpin, & N. Pyrhönen (Eds.), Europe in the Age of Post-Truth Politics: Populism, Disinformation and the Public Sphere (f. 1-9). Cham: Palgrave Macmillan. https://doi.org/10.1007/978-3-031-13694-8_1

Prej atëherë e deri më tash, çrregullimi informativ, i shprehur në forma të ndryshme, nuk konsiderohet më sfidë vetëm e një vendi, por është bërë pjesë e politikës në të gjithë botën dhe, sipas autorëve seriozë që merren me trajtimin teorik e akademik të këtij fenomeni, fatkeqësisht duket se është normalizuar në fjalorin dhe komunikimin politik.[4] Për më tepër, lajmet e rreme dhe mënyrat e tjera të keqinformimit, në kontekst të çrregullimit informativ, po shihen si faktori kryesor për rënien e demokracisë, në njërën anë, dhe rritjen e autoritarizmit, populizmit, racizmit dhe polarizimit të shoqërisë, në anën tjetër.[5]

Për më tepër, lajmet e rreme dhe mënyrat e tjera të keqinformimit, në kontekst të çrregullimit informativ, po shihen si faktori kryesor për rënien e demokracisë, në njërën anë, dhe rritjen e autoritarizmit, populizmit, racizmit dhe polarizimit të shoqërisë, në anën tjetër.[4]

Kjo qasje e kombinuar teorike, akademike dhe profesionale e tredeve të çrregullimit informativ është e rëndësishme për t'i kuptuar tendencat e këtij fenomeni në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në përgjithësi, si dhe në Kosovë, në veçanti, i cili është edhe qëllimi kryesor i këtij raporti me karakter monitorues dhe hulumtues për gjendjen e keqinformimit në Kosovë gjatë periudhës njëvjeçare korrik 2023 - qershor 2024.

Lajmet e rreme dhe llojet tjera të keqinformimit, në kontekst të çrregullimit informativ, po shihen si faktori kryesor për rënien e demokracisë, në njërën anë, dhe rritjen e autoritarizmit, populizmit, racizmit dhe polarizimit të shoqërisë, në anën tjetër.

[4] Egelhofer, J. L., Aaldering, L., Eberl, J.-M., Galyga, S., & Lecheler, S. (2020). From Novelty to Normalization? How Journalists Use the Term "Fake News" in their Reporting. *Journalism Studies*, 21:10, 1323-1343. <https://doi.org/10.1080/1461670X.2020.1745667>

[5] Monsees, L. (2021). Information disorder, fake news and the future of democracy. *Globalizations*, 20:1, 153-168. 2]

II. ANALIZË E TË DHËNAVE MONITORUESE TË ÇRREGULLIMIT INFORMATIV NË KOSOVË

Çrregullimi informativ është emëruesi i përbashkët për lloje e mënyra të ndryshme të keqinformimit. Me qëllim të përfshirjes së të gjitha mënyrave dhe formave në të cilat ai zhvillohet, “hibrid.info” e ka ndarë keqinformimin në disa kategori vlerësimi, bazuar edhe në metodologjinë e punës, të pranuar nga Rrjeti Ndërkombëtar për Kontrollimin e Fakteve (International Fact-Checking Network – IFCN) dhe nga Rrjeti Evropian i Standardeve për Kontroll të Fakteve (European Fact-Checking Standards Network) si në vijim:[6]

[6] Në këtë raport pasqyrohen ato kategori vlerësimi në të cilat ka pasur më së shumti publikime keqinformuese. Për më shumë detaje, shih metodologjinë e “hibrid.info” në të cilën janë të detajuara konceptet dhe shpjegimet e kategorive të vlerësimit të çrregullimit informativ: <https://hibrid.info/metodologjia/>

- Clickbait
- Dezinformatë
- Gabim
- Lajm i rremë
- Manipulim i fakteve
- Mashtrim
- Përmbajtje e paverifikuar
- Teori konspirative

Kontekstin

Qëllimet

Akterët dhe institucionet e përfshira në keqinformim

[6] Në këtë raport pasqyrohen ato kategori vlerësimi në të cilat ka pasur më së shumti publikime keqinformuese. Për më shumë detaje, shih metodologjinë e “hibrid.info” në të cilën janë të detajuara konceptet dhe shpjegimet e kategorive të vlerësimit të çrregullimit informativ: <https://hibrid.info/metodologjia/>

Ky raport vjetor analizon të dhënat e keqinformimit për periudhën vjetore korrik 2023 – qershor 2024 dhe për këtë “hibrid.info” ka publikuar dymbëdhjetë raporte monitoruese në bazë mujore^[7] për gjendjen e keqinformimit në Kosovë. Synimi është të jepet një sqarim më objektiv rreth gjendjes së informimit dhe të shpjegohen tendencat e keqinformimit ose çrregullimit informativ për periudhën monitoruese. Platforma “hibrid.info” krahason të dhënat mbi çrregullimin informativ në çdo raport mujor të grumbulluar nga baza e të dhënave përmes shtatë kategorive krahasuese të cilat analizohen në këtë raport:

1

Kategoritë për vlerësimin e çrregullimit informativ

2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

3

Fushat në të cilat u shpërndanë përmbajtje keqinformuese

4

Llojet e publikuesve që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

5

Llojet e mediave sociale dhe publikuesit në mediat sociale

6

Institucionet dhe personalitetet e përfolura

7

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave/premtimeve të zyrtarëve politikë dhe institucionalë, si dhe figurave publike në Kosovë

[7] Shih raportet monitoruese të publikuara në baza mujore nga “hibrid.info”: <https://hibrid.info/category/publikimet/raportet-mujore/>

1. Kategoritë vlerësuese të keqinformimit



Kjo pjesë e raportit shqyrton dhe analizon artikujt me përmbajtje keqinformuese sipas vlerësimeve që kanë marrë nëpër kategoritë e ndryshme të çrregullimit informativ përgjatë periudhës vjetore. Metodologjia e “hibrid.info” përcakton kriteret se cilat janë kategoritë e vlerësimit të publikimeve keqinformuese dhe në çfarë mënyre një artikull i caktuar keqinformues mund të vlerësohet.[8]

Gjatë periudhës korrik 2023 – qershor 2024, artikujt e vlerësuar në kategorinë “Clickbait” kanë mbizotëruar më së shumti në raport me kategoritë tjera vlerësuese të publikuara dhe shpërndara nga publikues të ndryshëm. Ato janë në vendin e parë me 22% gjithsej, të cilat pasohen nga artikujt keqinformues të vlerësuar si “Dezinformatë” me 21%. Dallimi në përqindje mes artikujve “Clickbait” dhe “Dezinformatë” është i ngushtë me vetëm 1% siç shihet në Figurën 1.

Të dhënat monitoruese të platformës “hibrid.info” tregojnë se këto dy kategori (“Clickbait” dhe “Dezinformatë”) kanë dominuar më së shumti gjatë kësaj periudhe vjetore. Gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit (korrik 2023 – qershor 2024), artikujt “Clickbait” kanë qenë në krye të listës më shpesh se sa artikujt e vlerësuar si “Dezinformatë”, të cilët në shumicën e rasteve janë renditur pas tyre në vendin e dytë.

Megjithatë, në rastet kur kishte më shumë artikuj keqinformues në fushën e politikës dhe sigurisë për dhe rreth Kosovës, artikujt “Clickbait” ishin mbrapa artikujve “Dezinformatë”, veçanërisht gjatë muajve tetor 2023, dhjetor 2023 dhe prill-maj 2024 që ndërlidhet me ngjarje politike dhe të sigurisë në komunat veriore të Kosovës. Ndërkaq, shpeshtësia e raportimeve me përmbajtje keqinformuese për kronikën e zezë dhe çështjet sociale ka ndikuar që të ketë më shumë artikuj “Clickbait” dhe më pak “Dezinformatë”. Kjo vërehet veçanërisht gjatë muajve korrik-shtator 2023 dhe shkurt-mars 2024.

Përmbajtjet keqinformuese që kanë marrë vlerësime të tjera në këtë periudhë përfshijnë kategoritë “Lajm i rremë” (15%), “Përmbajtje e paverifikuar” (14%), “Mashtrim” (10%) dhe kategori të tjera vlerësuese të çrregullimit informativ.

[8] Metodologjia e platformës “hibrid.info” për luftën kundër çrregullimit informativ gjendet këtu: <https://hibrid.info/metodologjia/>




Fig 1. Publikimet keqinformuese sipas kategorive vlerësuese të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

Analizimi i artikujve keqinformues në kategorinë vlerësuese “Clickbait”

Në kuadër të kategorisë vlerësuese “Clickbait”, sikurse në periudhën paraprake monitoruese, edhe gjatë kësaj periudhe vjetore janë publikuar dhe shpërndarë më së shumti artikuj keqinformues në fushën e kronikës së zezë dhe temave sociale që nxisin kureshtjen e lexuesve për të klikuar në publikime të tilla. Këta artikuj kryesisht trajtojnë tema të rasteve tragjike, vdekjeve, kushteve klimatike, tërmete, produkte ushqimore, raste të dhunës, aksidente, çmimet dhe tema të tjera sociale apo të kronikës së zezë. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, 45% e publikimeve “Clickbait” janë për kronikën e zezë dhe 23% të tjera për temat sociale.

Kurse, për fusha të tjera ka pasur shumë më pak artikuj keqinformues, si për politikën, sigurinë, sportin etj., marrë parasysh se kronika e zezë dhe çështjet sociale përbëjnë rreth 68% të publikimeve keqinformuese në kategorinë “Clickbait”

duke lënë mbrapa fushat tjera tematike siç shihet në Figurën 2.

Nga monitorimi i platformës “hibrid.info”, vërehet se të gjithë artikujt keqinformues në këtë kategori janë publikuar në shqip, kryesisht nga media reale dhe në përqindje më të vogël nga publikues të tjerë. Mediat reale kanë publikuar më së shumti artikuj me përmbajtje të tillë prej 83% gjithsej, kurse publikues të tjerë dukshëm më pak, siç janë publikues të ndryshëm në Facebook prej 11% dhe portale të dyshimta prej 6%. Kjo konfirmon prirjen e analizuar në raportet e mëhershme monitoruese të “hibrid.info” se media dhe publikues në shqip që publikojnë artikuj keqinformues në kategorinë “Clickbait” kanë nevojë të fitojnë më shumë audiencë në formatin online.[9]

Sipas të dhënave monitoruese, përmbajtjet keqinformuese të publikuara në temat dhe

[9] Avdiu, P., & Osmani, S. (2023). Prapa Ekranëve: Raport vjetor për gjendjen e çrregullimit informativ, f. 20.

fushat e kategorisë “Clickbait” nga ana e mediave reale kryesisht nuk kanë për qëllim të keqinformojnë domosdoshmërisht. Për më tepër, ato shpërndajnë artikuj të tillë për shkak të kureshtjes së lexuesve për shfletim të

artikujve të tillë, ndikojnë në rritje të lexueshmërisë dhe klikimeve në mediat sociale.[10] Kjo çështje trajtohet edhe në seksione vijuese të raportit tek fushat dhe temat më të shpeshta të keqinformimit.




Fig 2. Fushat tematike me më së shumti keqinformime në kategorinë “Clickbait” (korrik 2023 - qershor 2024)

Analizimi i artikujve keqinformues në kategorinë vlerësuese “Dezinformatë”

Sa i përket artikujve keqinformues me përmbajtje të vlerësuar si dezinformatë, më së shumti kanë trajtuar çështje politike dhe të sigurisë në varësi të dinamikës së ngjarjeve në këto dy fusha. Pjesa më e madhe e dezinformatave janë publikuar në shqip prej 85%, në kuadër të së cilave përfshihen publikuesit në gjuhën shqipe në mediat sociale (61%) me më së shumti dezinformata të publikuara, mediat reale (12%) dhe mediat e dyshimta (12%). Kurse, pjesa e dezinformatave të tjera ose 14% e tyre janë publikuar në gjuhën serbe kryesisht nga mediat reale në gjuhën serbe prej 12% dhe 2% të tjera nga publikues

në mediat sociale në gjuhën serbe. Në këtë rast duhet të jepet shpjegimi se ndryshe prej publikimeve keqinformuese në gjuhën shqipe ku monitorohen të gjitha llojet e publikuesve (mediat reale, publikuesit në mediat sociale dhe mediat e dyshimta), tek publikimet në gjuhën serbe monitorohen me theks të veçantë mediat reale në gjuhën serbe dhe, sipas rasteve, publikues në mediat sociale që shpërndajnë artikuj për Kosovën në gjuhën serbe, të cilat krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje keqinformuese lidhur me zhvillimet rreth Kosovës në fushat e politikës dhe sigurisë.

[10] Po aty.

Karakteristikë kryesore e dezinformatave të publikuara gjatë kësaj periudhe është se shumica dërrmuese e tyre janë krijuar dhe shpërndarë nga publikues të ndryshëm në mediat sociale. Në këtë rast, 64% e dezinformatave janë krijuar nga publikues në mediat sociale (në Facebook 75% dhe në TikTok 25%) dhe pothuajse të gjitha prej tyre ose 95% janë publikuar në shqip dhe pjesa tjetër, gjegjësisht 5% në gjuhë të tjera (në gjuhët serbe dhe angleze) në Facebook, Instagram, X (ish-Twitter) dhe Telegram. Ndërkaq, në mediat reale janë publikuar vetëm 24% e dezinformatave, prej të cilave 51% në gjuhën shqipe dhe 49% në atë serbe. Kurse, media të dyshimta kanë publikuar dukshëm më pak dezinformata (12%).

Bazuar në të dhënat e monitorimit , gjatë kësaj periudhe vjetore dezinformatat më së shumti janë publikuar dhe shpërndarë në fushën e sigurisë me 37% dhe politikës me 30% (shih Figurën 3). Kjo nënkupton se 2/3 e tyre ose 67% e artikujve që janë vlerësuar si dezinformata ndërlidhen drejtpërdrejtë me ngjarje të sigurisë dhe politikës, duke lënë mbrapa fushat e tjera, si çështjet sociale (17%), sportin (6%), kronikën e zezë (5%) etj. Këto të dhëna konfirmojnë analizat paraprake të platformës "hibrid.info" se publikimet keqinformuese në fushat e sigurisë dhe politikës ndikojnë në rritjen e dezinformatave si kategori vlerësimi të çrregullimit informativ[12], kurse artikujt keqinformues me përmbajtje të kronikës së zezë dhe çështjeve sociale rrisin në anën tjetër publikimet në kategorinë "Clickbait" siç u vërejt gjatë shqyrtimit të kësaj kategorie vlerësimi të keqinformimit. Në këtë mënyrë mund të shpjegohen shkaqet se pse gjatë muajve të kësaj periudhe

vjetore (korrik 2023 – qershor 2024) kishte luhatje të shpeshta mes kategorive "Clickbait" dhe "Dezinformatë", varësisht prej raportimeve të mediave dhe publikuesve të ndryshëm.

Publikuesit në gjuhën shqipe kanë shpërndarë më së shumti dezinformata për ngjarje të sigurisë dhe, për dallim nga periudha paraprake, ato kanë trajtuar më së shumti temën e konfliktit mes Izraelit dhe Hamasit dhe jo ngjarje për dhe rreth Kosovës. Dezinformatat për ngjarjet e këtij konflikti që nuk ndërlidhet me Kosovën, por me një ngjarje ndërkombëtare, janë publikuar nga publikues në mediat sociale (të gjitha prej tyre janë shpërndarë në Facebook), publikimet e të cilave konsiderohen si pro-islamike me përmbajtje në gjuhën shqipe. Këto publikime përmbajnë dezinformata të ndryshme për konfliktin Izrael-Hamas, duke shfaqur imazhe të ndryshme përmes inteligjencës artificiale, video materiale që nuk paraqesin gjendjen e konfliktit etj. Kjo është një nga rastet e rralla kur ka më shumë dezinformata në fushën e sigurisë për një konflikt të huaj dhe jo në mënyrë të veçantë me dinamikën e ngjarjeve të sigurisë në Kosovë. Pas konfliktit mes Izraelit dhe Hamasit, dezinformatat në shqip, në fushën e sigurisë, ndërlidhen me veriun e Kosovës për sulmin terrorist në fshatin Banjskë të Zveçanit kundër pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në shtator të vitit 2023, për shpërthime në veri, si dhe pas veriut kanë dominuar edhe raportime dezinformuese për luftën në Ukrainë, armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës etj. Pas sigurisë, publikuesit në shqip kanë publikuar dezinformata edhe për çështje politike dhe në vendin e parë janë publikimet për konfliktin Izrael-Hamas

[12] Po aty, fq. 18-19.

e cila pasohet nga raportime për rrëzimin e Qeverisë Kurti, veriun e Kosovës, vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës për ndalimin e dinarit serb në Kosovë, masat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës etj. Dezinformatat tjerë në shqip, por në numër dukshëm më të vogël në krahasim me sigurinë dhe politikën, i përkasin çështjeve sociale, sportit, kronikës së zezë, shëndetësisë dhe fushave të tjera tematike.

Edhe dezinformatat e krijuara dhe shpërndara nga publikuesit në gjuhën serbe janë kryesisht për çështje politike dhe të sigurisë, por që ndërlidhen drejtpërdrejtë me zhvillimet në Kosovë në këto dy fusha. Pothuajse të gjitha dezinformatat në gjuhën serbe janë publikuar nga media reale dhe vetëm një pjesë e vogël, për të mos thënë e papërfillshme, janë publikuar në mediat sociale nga publikues në gjuhën serbe. Dezinformatat e publikuara në gjuhën serbe trajtojnë më së shumti veriun e Kosovës për sulmin në Banjskë dhe

pretendimet e mediave në gjuhën serbe se Policia e Kosovës po terrorizon serbët në komunat veriore të Kosovës. Këta publikues kanë shpërndarë edhe dezinformata tjera ndaj kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për intervenimin e NATO-s me 1999, trazirat e marsit më 2004 në Kosovë, komunat me shumicë serbe, etj. Këto publikime keqinformuese në gjuhën serbe me përmbajtje dezinformuese janë pjesë e narrativëve serbe për të keqinformuar lidhur me zhvillimet në Kosovë pa u bazuar në saktësim apo verifikim të fakteve dhe burimeve të informacionit me qëllim të dezinformimit për ngjarje për dhe rreth Kosovës.[13] Sipas njohësve të mediave në Kosovë, narrativi serb kundrejt Kosovës është i ngjashëm ose e kopjon narrativen ruse ndaj Ukrainës për ta kualifikuar Kosovën si “shtet të dështuar” dhe e cila shfrytëzohet nga mediat e afërta me pushtetin në Serbi për të krijuar dhe shpërndarë dezinformata të tilla kundër Kosovës.[14]




Fig 3. Fushat tematike me më së shumti keqinformime në kategorinë “Dezinformatë” (korrik 2023 - qershor 2024)

[13] Po aty,

[14] Grupi i fokusit me njohës dhe ekspertë të mediave organizuar nga “hibrid.info”. Prishtinë, 6 qershor 2024.

2. Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Të dhënat e monitorimit tregojnë se pavarësisht dinamikës së ngjarjeve politike dhe të sigurisë në Kosovë gjatë muajve të vitit 2023 dhe 2024, me theks të veçantë në veriun e Kosovës (rasti i Banjskës, referendumi në komunat veriore të Kosovës për largimin apo jo të kryetarëve të komunave etj.), megjithatë një ngjarje tjetër jashtë Kosovës, siç është konflikti Izrael-Hamas, ka nxitur publikuesit në shqip që të krijojnë dhe shpërndajnë më së shumti artikuj me përmbajtje keqinformuese përgjatë kësaj periudhe. Rreth 10% e temave të publikuara janë për këtë konflikt në Lindjen e Mesme, siç dëshmohet në Figurën 4. Në vendin e dytë

janë rastet tragjike me përmbajtje keqinformuese prej 6.5%, e cila pasohet nga veriu me 6.3% dhe raportime të ndryshme keqinformuese në lidhje me armatosjen e Forcës së Sigurisë prej 4%.

Temat tjera mbi të cilat publikues të ndryshëm kanë publikuar dhe shpërndarë artikuj keqinformues janë për dhënie të kredive (3%), vdekje (2%) dhe tema të tjera.

Në vijim analizohen përmbledhtazi temat kryesore të monitoruara gjatë kësaj periudhe vjetore.




Fig 4. Temat kryesore të keqinformimit (korrik 2023 - qershor 2024)

Konflikti Izrael-Hamas

Pothuajse të gjitha përmbajtjet e destinuar për audiencën vendore për konfliktin mes Izraelit dhe Hamasit të trajtuara/kontrolluara, janë publikuar në shqip (98%) dhe vetëm dy artikuj të tjerë në gjuhë të huaja (një artikull në anglisht dhe një tjetër në serbisht që përbëjnë rreth 2%). Gjithashtu, gati të gjitha këto publikime keqinformuese janë publikuar dhe shpërndarë nga publikues në gjuhën shqipe në mediat sociale (rreth 96%), gjegjësisht pothuajse shumica absolute e tyre janë publikuar në Facebook (91%) dhe një pjesë tjetër në numër më të vogël në TikTok (5%). Numri më i madh publikimeve të tilla janë publikuar gjatë muajve tetor-dhjetor 2023 (81%), por publikime të tilla kishte pasur edhe në muajt vijues janar-maj 2024, edhe pse në

përqindje më të ulët (19%). Shumica e këtyre keqinformimeve për konfliktin Izrael-Hamas janë publikuar dhe shpërndarë në Facebook nga faqe dhe llogari të ndryshme në shqip, ku publikimet e të cilave konsiderohen si pro-islamike. Këto publikime janë vlerësuar në masën më të madhe si përmbajtje e paverifikuar, dezinformata dhe lajme të rreme, si dhe i përkasin më së shumti fushës së sigurisë (63%), sociale (23%) dhe politikës (14%). Platforma "hibrid.info" ka gjetur se ky është konflikti i parë ndërkombëtar kur për herë të parë është përdorur intelijenca artificiale për të sajuar imazhe me pretendimin se paraqet gjendjen e konfliktit mes Izraelit dhe Hamasit, e të cilat janë vlerësuar si përmbajtje keqinformuese. [15]

Konflikti Izrael-Hamas	Kategoritë e vlerësimit		Fushat		Llojet e publikuesve		Media sociale		Gjuha	
	Përmbajtje e paverifikuar	47%	Siguri	63%	Media sociale	96%	Facebook	91%	Shqip	98%
	Dezinformatë	30%	Sociale	23%	Media reale	3%	TikTok	5%	Anglisht	1%
	Lajm i rremë	10%	Politika	14%	Media të dyshimta	1%			Serbisht	1%
	Të tjera	13%								

Fig 5: Ndërveprimi i temës së konfliktit Izrael-Hamas me kategoritë e ndryshme të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

[15] Grupi i fokusit me njohës dhe ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 6 qershor 2024.

Rastet tragjike

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese për rastet tragjike janë publikuar në gjuhën shqipe. Mediat reale kanë publikuar më së shumti artikuj me përmbajtje të tillë keqinformuese prej 84%, pasuar nga publikuesit në mediat sociale prej 14% dhe mediat e dyshimta 2%. Shumica

dërrmuese e rasteve tragjike i përkasin kategorisë “clickbait” në kuadër të kronikës së zezë dhe përmbajtjet keqinformuese në këtë temë trajtojnë vrasje e vdekje të ndryshme duke iu dhënë ngjyrimet tragjike atyre rasteve.

Raste tragjike	Kategoritë e vlerësimit		Fushat		Llojet e publikuesve		Media sociale		Gjuha	
	Clickbait	83%	Kronikë e zezë	96%	Media reale	84%	Facebook	10%	Shqip	100%
Dezinformatë	6%	Siguri	2%	Media sociale	14%	TikTok	4%			
Gabim	4%	Sociale	2%	Media të dyshimta	2%					
Të tjera	7%									

Fig 6: Ndërveprimi i temës së rasteve tragjike me kategoritë e ndryshme të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

Veriu

Pas rasteve tragjike, në vendin e tretë janë artikujt keqinformues mbi temën e veriut të Kosovës (6.3%) me një dallim shumë të ngushtë në përqindje me rastet tragjike (6.5%) prej 0.2%. Kjo është hera e parë që tema e veriut të Kosovës nuk mbizotëron sa i përket përmbajtjeve keqinformuese prej kur platforma për kontroll të fakteve “hibrid.info” ka nisur monitorimin e keqinformimit në Kosovë në korrik të vitit 2020. Ndërsa, dy vjet më vonë (korrik 2022), ka filluar publikimin e raporteve të rregullta mujore mbi gjendjen

e çrregullimit informativ, për të përfunduar me raportet analitike vjetore. Shumica e përmbajtjeve keqinformuese për këtë temë janë publikuar nga publikues në mediat sociale prej 62%, në mediat reale 32% dhe mediat e dyshimta 6%. Prej tyre, pjesa më e madhe janë publikuar në shqip prej 74% dhe atë kryesisht nga publikues që operojnë në gjuhën shqipe në mediat sociale prej 52% gjithsej, në të cilat mbizotëron Facebook (32%) dhe TikTok (18%), ndërsa më pak media tjetër sociale Telegram (2%). Kurse, nga monitorimi i

[15] Grupi i fokusit me njohës dhe ekspertë të mediave organizuar nga “hibrid.info”. Prishtinë, 6 qershor 2024.

mediave reale në gjuhën shqipe rezulton se ato kanë publikuar 16% të artikujve keqinformues për veriun dhe mediat e dyshimta 6%. Artikujt në gjuhën shqipe për veriun janë kryesisht në fushën e sigurisë lidhur me zhvillimet gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit (korrik 2023 – qershor 2024) në komunat veriore të Kosovës të kategorizuara si dezinformata, përmbajtje të paverifikuara dhe lajme të rreme. Ndërkaq, pjesa tjetër e keqinformimeve ose 24% e tyre janë publikuar në gjuhën serbe, prej të cilave 16% në mediat reale në gjuhën serbe dhe

8% nga publikues në media sociale (kryesisht në Telegram). Publikimet për veriun në gjuhën serbe janë krijuar dhe shpërndarë në fushën e sigurisë të vlerësuar si dezinformata dhe teori konspirative për sulmin terrorist serb në Banjskë, pretendime pa fakte se serbët në komunat veriore të Kosovës po sulmohen, shtrembërimet të fakteve ndaj Policisë së Kosovës etj. Ndërkaq, rreth 2% e publikimeve keqinformuese për veriun janë shpërndarë në gjuhën angleze nga publikues në mediat sociale.

	Kategoritë e vlerësimit		Fushat		Llojet e publikuesve		Media sociale		Gjuha	
	Veriu	Dezinformatë	38%	Siguri	84%	Media sociale	62%	Facebook	34%	Shqip
Përmbajtje e paverifikuar		22%	Politik	12%	Media reale	32%	TikTok	18%	Serbisht	24%
Lajm i rremë		14%	Sociale	4%	Media të dyshimta	6%	Telegram	8%	Anglisht	2%
Të tjera		26%					X (ish-Twitter)	2%		

Fig 7: Ndërveprimi i temës së veriut të Kosovës me kategoritë e ndryshme të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

Armatosja e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)

Tema për armatosjen e FSK-së ka nxitur vëmendjen e publikut dhe mediave pas blerjes së dronëve Bayraktar TB-2 prej institucioneve të Kosovës nga Turqia [16] në gjysmën e dytë të vitit 2023 dhe kërkesa e shtetit të Kosovës drejtuar

SHBA-së për blerjen e raketave kundërtanke Javelin gjatë muajit janar 2024. [17] Këta faktorë kanë ndikuar në rritjen e përmbajtjeve keqinformuese gjatë kësaj periudhe sipas gjetjeve të monitorimit nga “hibrid.info”. Të gjithë

[16] Koha.Net. (16 korrik 2023). [Kosova blen dronë Bayraktar](#).

[17] Radio Evropa e Lirë. (11 janar 2024). [DASH: Vlera e raketave kundërtanke që Kosova dëshiron t'i blejë është 75 milionë dollarë](#).

artikujt keqinformues për armatosjen e FSK-së janë publikuar në gjuhën shqipe. Pothuajse të gjitha prej tyre janë krijuar e shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale në gjuhën shqipe prej 94% dhe vetëm 6% nga mediat reale, prej të cilave dominojnë artikujt keqinformues të shpërndarë nga llogari të ndryshme në gjuhën shqipe në TikTok (61%), faqe të ndryshme në Facebook (31%) dhe kanale

në YouTube (3%). Kjo është një gjetje e rëndësishme e monitorimit që tregon se në TikTok janë publikuar më së shumti artikuj keqinformues për FSK-në gjatë kësaj periudhe vjetore. Gjithashtu, të gjithë artikujt për këto tema i përkasin fushës së sigurisë dhe rreth 2/3 ose 67% e tyre janë vlerësuar si lajme të rreme, pasuar nga dezinformata, përmbajtje e paverifikuar etj.

Armatojsja e FSK-së	Kategoritë e vlerësimit		Fushat		Llojet e publikuesve		Media sociale		Gjuha	
	Lajm i rremë	67%	Siguri	100%	Media sociale	94%	TikTok	61%	Shqip	100%
	Dezinformatë	14%			Media reale	6%	Facebook	31%		
	Përmbajtje e paverifikuat	14%					Youtube	3%		
	Të tjera	6%								

Fig 8: Ndërveprimi i temës së armatosjes së FSK-së me kategoritë e ndryshme të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

3. Fushat e keqinformimit

Gjatë kësaj periudhe vjetore të monitorimit të artikujve me bazë keqinformuese, publikuesit e ndryshëm kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e sigurisë me 27%. Pas saj janë keqinformimet për çështje sociale me 23%, e cila pasohet nga politika me 22%, kronika e zezë me 14% dhe fusha tjera tematike prej 14% (si sporti, moti, ekonomia, shëndetësia etj.).

Megjithatë, mund të thuhet se siguria dhe politika kanë mbizotëruar më së shumti gjatë kësaj periudhe prej 49% të dyja së bashku në krahasim me kronikën e zezë dhe çështjet sociale që përbëjnë rreth 37% të të gjithë artikujve keqinformues për periudhën korrik 2023 – qershor 2024.

Sa i përket fushës së sigurisë, publikuesit në shqip kanë publikuar më së shumti keqinformime prej 88%, në të cilat përfshihen publikuesit në mediat sociale me 72% me më së shumti përmbajtje keqinformuese për tema të sigurisë (kryesisht faqe dhe llogari në Facebook dhe TikTok), pasuar nga mediat reale me 14% dhe mediat e dyshimta me 2%. Ndërkaq, 11% e të gjitha publikimeve për sigurinë ishin publikuar në gjuhën serbe, përkatësisht 8% nga mediat reale në gjuhën serbe dhe 3% nga publikues serbë në mediat sociale, megjithatë theksi i monitorimit tek publikimet në gjuhën serbe ishin më tepër mediat reale se sa mediat sociale. Ndërkaq, vetëm 1% e publikimeve të monitoruara për sigurinë ishin krijuar




Fig 9: Fushat kryesore të keqinformimit (korrik 2023 - qershor 2024)

nga publikues në mediat sociale në gjuhën angleze. [U1] [PA2] Duket se arsyeja kryesore që ka dominuar fusha e sigurisë për këtë periudhë qëndron në faktin se më së shumti publikime keqinformuese ka pasur për konfliktin Izrael-Hamas nga publikuesit në shqip në mediat sociale, të cilat pasohen nga keqinformimet për veriun në vendin e dytë, armatosja e Forcës së Sigurisë së Kosovës, lufta në Ukrainë, sulmi i Iranit ndaj Izraelit etj. Kjo nënkupton se publikuesit e përmbajtjeve keqinformuese në shqip, në fushën e sigurisë, nuk janë duke u kufizuar në shtrembërimin e lajmeve vetëm për zhvillimet e brendshme të sigurisë në Kosovë, por edhe në tema të tjera, si konfliktet në Lindjen e Mesme apo edhe pushtimi i Ukrainës nga Rusia që nuk ndërlidhen me Kosovën. Shumica dërrmuese e keqinformimeve në fushën e sigurisë janë krijuar e shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale në shqip. Publikimet në fushën e sigurisë në shqip kanë marrë më së shumti vlerësime të dezinformatës, lajmeve të rreme dhe përmbajtjes së paverifikuar. Ndërkaq, publikimet në gjuhën serbe janë publikuar kryesisht nga mediat reale në gjuhën serbe në formën e teorive konspirative dhe dezinformatave lidhur me çështje të sigurisë në veriun e Kosovës, për vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë etj.

Publikimet keqinformuese për çështje sociale janë krijuar kryesisht në shqip dhe shumica prej tyre (59%) janë shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale, kryesisht në Facebook dhe TikTok, ndërsa pjesa tjetër në mediat reale (30%) dhe mediat e dyshimta (11%). Ngjashëm si në fushën e sigurisë, konflikti ndërmjet Izraelit dhe Hamasit ka qenë tema më e trajtuar edhe

tek fusha sociale gjatë kësaj periudhe në lidhje me keqinformime të ndryshme për këtë temë. Ajo pasohet nga artikuj keqinformues për dhënie të kredive, punë në Zvicër, produkte shëruese, lojë shpërblyese, çmimin e bukës etj. Përmbajtjet keqinformuese me tematikë sociale janë vlerësuar më së shumti në kategorinë "Mashttrim" dhe "Clickbait", si dhe në numër më të vogël si "Dezinformatë", "Përmbajtje e paverifikuar" etj.

Edhe tek artikujt e publikuar keqinformues në fushën politike kanë mbizotëruar publikimet për konfliktin Izrael-Hamas, zhvillimet rreth veriut të Kosovës dhe dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Njëjtë si me publikimet keqinformuese në fushën e sigurisë, edhe tek politika dominojnë më së shumti dezinformatat dhe lajmet e rreme si kategori të çrregullimit informativ, ndërsa në numër më të vogël artikujt "clickbait" dhe mashttime. Shumica dërrmuese e keqinformimeve në fushën politike janë publikuar në shqip (83%) nga të cilat 48% nga publikuesit në mediat sociale, 33% në mediat reale dhe 2% në media të dyshimta që operojnë në gjuhën shqipe. Publikimet keqinformuese në gjuhën shqipe në kuadër të fushës së politikës janë për konfliktin Izrael-Hamas, dialogun Kosovë-Serbi, veriun, rrëzimin e Qeverisë Kurti etj. Ndërkaq, rreth 16% të publikimeve keqinformuese për çështje politike ishin në gjuhën serbe të publikuara kryesisht nga mediat reale me 14% dhe 2% nga publikues në mediat sociale që operojnë në gjuhën serbe. Përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe ndërlidhen me situatën politike në Kosovë, përfshirë veriun, vendbanimet dhe komunitat me shumicë serbe në Kosovë, komunitetin serb etj. Në krahasim me fushat tjera të

trajtuara më lartë, ku publikuesit në mediat sociale kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues për tema të sigurisë dhe sociale, në fushën politike kanë publikuar pothuajse në mënyrë të barabartë publikuesit në mediat sociale (50%) dhe mediat reale (48%), megjithëse edhe këtu dominojnë me një dallim të lehtë publikimet e publikuesve në mediat sociale ndaj mediave reale.

Sa i përket kronikës së zezë, të gjitha publikimet keqinformuese në këtë fushë tematike janë publikuar në shqip dhe

shumica dërrmuese e tyre janë vlerësuar në kategorinë “clickbait” dhe në përqindje dukshëm më të ulëta janë lajmet e rreme, dezinformatat dhe përmbajtjet e paverifikuara. Shumica e artikujve keqinformues në kronikën e zezë janë për raportime të rasteve tragjike, vdekjeve, vrasjeve, aksidenteve etj. Dallimi qenësor me fushat e tjera tematike është se pjesa më e madhe e artikujve keqinformues për kronikën e zezë janë publikuar nga mediat reale në shqip prej 71%, publikuesit në mediat sociale rreth 24% dhe media të dyshimta 5%.




Fig 10: Vlerësimi i artikujve keqinformues sipas kategorive vlerësuese të çrregullimit informativ në bazë të fushave tematike (korrik 2023 - qershor 2024)



4. Llojet e publikuesve të keqinformimit

Ndër gjetjet kryesore të këtij raporti është tendenca që gjatë muajve të kësaj periudhe monitorimi (korrik 2023 – qershor 2024) ka pasur një dinamikë të theksuar nga publikues të ndryshëm për të krijuar dhe shpërndarë më shumë artikuj keqinformues në mediat sociale se sa në mediat reale apo ato të dyshimta. Në këtë rast vërehet intensitet i shtuar i publikimeve keqinformuese në mediat sociale nga faqe, llogari dhe publikues të ndryshëm në shqip, kryesisht në Facebook dhe TikTok. Për më tepër, shihet se ka rënie të dukshme të artikujve me përmbajtje keqinformuese në mediat reale dhe mediat e dyshimta si pasojë e rritjes së këtyre publikimeve nga publikuesit e mediave sociale.

Me përjashtim të tre muajve të periudhës së monitorimit – korrik 2023, gusht 2023 dhe shkurt 2024 kur kishte më shumë publikime keqinformuese në mediat reale – në të gjitha periudhat e tjera mujore janë publikuar më shumë artikuj keqinformues në mediat sociale nga publikuesit në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, 56% e publikimeve keqinformuese ishin publikuar në mediat sociale, 39% në mediat reale dhe vetëm 5% në media të dyshimta.




Fig 11: Llojet e publikuesve që kanë shpërndarë artikuj keqinformues (korrik 2023 - qershor 2024)

Të dhënat në figurën e mëposhtme dëshmojnë se në cilat kategori vlerësuese të çrregullimit informativ kanë qenë më të përhapura përmbajtjet keqinformuese. Publikuesit në mediat sociale kanë qenë të fokusuar kryesisht në krijim dhe shpërndarje të artikujve keqinformues në kategoritë e dezinformatës dhe lajmeve të rreme prej 14% secila prej tyre, si dhe në

përmbajtje të paverifikuara (11%) dhe mashtrim (10%). Përkundrazi, mediat reale kanë publikuar më së shumti publikime keqinformuese në kategorinë “clickbait” prej 18%, ndërsa mediat e dyshimta kryesisht dezinformata (3%) ndonëse mediat e dyshimta kanë publikuar dukshëm më pak në krahasim me dy llojet tjera të publikuesve (media sociale dhe reale).




Fig 12: Shpërndarja e artikujve keqinformues nga publikuesit në bazë të kategorive vlerësuese të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

Monitorimi nga platforma “hibrid.info” për këtë periudhë njëvjeçare të çrregullimit informativ në Kosovë ka nxjerrë në sipërfaqe se publikuesit në mediat sociale (ku pothuajse të gjithë prej tyre janë në gjuhën shqipe prej 98%) kanë publikuar artikuj keqinformues më së shumti në fushën e sigurisë (20%), fusha sociale në vendin e dytë (14%) dhe ajo politike në të tretin (11%). Megjithatë, vërehet se fokusi i

këtyre publikuesve ishte në sferën e sigurisë dhe politikës, duke marrë parasysh se këto dy fusha janë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Mediat reale kanë publikuar më së shumti keqinformime për politikë (11%), kronikë të zezë (10%), pasuar nga temat sociale (7%) dhe siguria (6%). Ndërkaq, mediat e dyshimta kanë shpërndarë kryesisht artikuj keqinformues për çështjet sociale (2%).




Fig 13: Shpërndarja e artikujve keqinformues nga publikuesit në bazë të fushave tematike (korrik 2023 - qershor 2024)

Gjatë kësaj periudhe vjetore, publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues dhe atë pothuajse në mënyrë absolute. Rreth 91% e publikimeve janë krijuar dhe shpërndarë nga publikues të ndryshëm në shqip, gjegjësisht 54% e tyre nga publikuesit në

mediat sociale, 32% nga mediat reale dhe 5% nga portalet e dyshimta. Kurse, rreth 8% e publikimeve janë në gjuhën serbe, kryesisht nga mediat reale dhe në gjuhën angleze 1% nga publikues në mediat sociale.




Fig 14: Publikimet keqinformuese nga të gjitha llojet e publikuesve në gjuhët shqipe, serbe dhe të tjera (korrik 2023 - qershor 2024)

5. Llojet e mediave sociale



Gjatë kësaj periudhe monitorimi të gjendjes së keqinformimit në Kosovë vërehet trendi në rritje i artikujve keqinformues në gjuhën shqipe në mediat sociale, siç u dëshmuua edhe në seksionin paraprak. Metodologjia e punës së platformës “hibrid.info” për luftën kundër çrregullimit informativ përcakton qartë kriteret lidhur me përmbajtjet keqinformuese që monitorohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së artikujve me përmbajtje keqinformuese bëhen si në vijim: I) rëndësia e përmbajtjes duke u fokusuar në rëndësinë e informacionit dhe përfshirjen e personave në informacionin e shpërndarë, II) ndikimi që mund të ketë përmbajtja tek audienca për shkak të rëndësisë politike, socio-ekonomike etj., dhe III) viraliteti apo rrjedha shpërndarëse e përmbajtjes duke përfshirë mediat reale, portalet e dyshimta dhe mediat sociale. [18] Bazuar në këto kriteret metodologjike

të përzgjedhjes së përmbajtjeve keqinformuese, atëherë edhe përmbajtjet keqinformuese të monitoruara për tema të ndryshme janë publikuar më së shumti në media sociale ose më shumë se gjysma e tyre (56%), kryesisht nga faqe dhe llogari në Facebook dhe TikTok që operojnë në gjuhën shqipe, por edhe në media të tjera sociale.

Gjatë kësaj periudhe vjetore, sa i përket mediave sociale, publikues të ndryshëm në Facebook, në shqip, kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues prej 38% gjithsej, për tema jo vetëm për Kosovën, por edhe për zhvillime ndërkombëtare. Në vendin e dytë janë publikimet keqinformuese në TikTok me 14%, ndërsa mediat tjera sociale kanë dukshëm përqindje më të ulët prej 4% (Telegram, X, YouTube, Instagram dhe Reddit).




Fig 15: Publikimet keqinformuese në mediat sociale (korrik 2023 - qershor 2024)

[18] Shih metodologjinë e platformës “hibrid.info” për luftën kundër çrregullimit informativ: <https://hibrid.info/metodologjia/>

5.1. Llojet e publikuesve në mediat sociale

Analiza e të dhënave se cilët publikues kanë krijuar dhe shpërndarë më shumë artikuj me përmbajtje keqinformuese në mediat sociale jep një pasqyrë edhe më të detajuar për të kuptuar më qartë trendet e keqinformimit në Kosovë. Platforma "hibrid.info" monitoron publikues të ndryshëm që shpërndajnë përmbajtje keqinformuese, siç janë: faqe, llogari, profile, media, faqe zyrtare dhe kanale të ndryshme që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Figura 16 tregon se faqe të ndryshme në Facebook kanë publikuar më së shumti

përmbajtje keqinformuese gjatë kësaj periudhe. Rreth 29% e artikujve keqinformues të monitoruar janë publikuar nga faqet në Facebook, kurse publikuesit e tjerë në këtë media sociale kanë publikuar, por në përqindje më të vogël. Në vendin e dytë janë llogari të ndryshme në TikTok që, sipas të dhënave, kanë publikuar 14% të artikujve keqinformues që janë monitoruar për këtë periudhë vjetore. Ndërkaq, mediat tjera sociale, si Telegram, X, YouTube, Instagram dhe Reddit, kanë publikuar dukshëm më pak përmbajtje keqinformues për dhe rreth Kosovës.




Fig 16: Publikuesit e artikujve keqinformues nga publikuesit e ndryshëm në mediat sociale (korrik 2023 - qershor 2024)

Publikuesit në mediat sociale kanë publikuar kryesisht lajme të rreme dhe dezinformata prej 14% secila prej tyre si dhe përmbajtje të paverifikuar prej 10%, si dhe në kategori të tjera të çrregullimit informativ. Kur kategoritë e keqinformimit

degëzohen për secilën media sociale, vërehet se publikuesit në Facebook kanë qenë të fokusuar në publikimin e dezinformatave dhe përmbajtjes së paverifikuar, kurse në TikTok janë publikuar më së shumti lajme të rreme.




Fig 17: Publikimet e artikujve keqinformues në mediat sociale sipas kategorive vlerësuese të çrregullimit informativ (korrik 2023 - qershor 2024)

Analizimi i të dhënave se cilat kanë qenë fushat dhe temat më të trajtuara nga publikuesit në mediat sociale përgjatë kësaj periudhe vjetore tregon se fusha e sigurisë ka qenë interesi i kryesor i këtyre publikuesve, e cila pasohet nga fusha sociale dhe politika. Në këtë rast, në Facebook ishin krijuar dhe shpërndarë përmbajtje keqinformuese më së shumti për ngjarje të sigurisë dhe çështje sociale, kurse në TikTok kishin dominuar kryesisht çështje të sigurisë, megjithëse në këtë media sociale kishte dukshëm më pak publikime në krahasim me Facebook.

Gjetja më e rëndësishme nga monitorimi për këtë periudhë sa i përket mediave sociale është se përmbajtjet keqinformuese lidhur me temën e konfliktit Izrael-Hamas janë publikuar pothuajse në mënyrë absolute nga publikuesit në mediat sociale në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave, 96% e përmbajtjeve për këtë konflikt të huaj janë publikuar në mediat sociale, gjegjësisht 91% në Facebook dhe 5% në TikTok, kurse të tjera në mediat reale (3%) dhe mediat e dyshimta (1%). Arsyet kryesore të monitorimit të artikujve keqinformues mbi konfliktin Izrael-Hamas

janë se përmbajtjet mbi këtë temë kanë mbizotëruar mbi të gjitha temat tjera dhe se kjo temë ka pasur ndikim të madh, veçanërisht nga përdorues të ndryshëm në mediat sociale si temë që ka nxitur klikime dhe komente të shumta në Facebook dhe TikTok, në të cilat janë publikuar artikujt

keqinformues për konfliktin mes Izraelit dhe Hamasit. Sa i përket temave të tjera, veriu i Kosovës dhe armatosja e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë temat më të trajtuara nga publikuesit në mediat sociale pas konfliktit Izrael-Hamas.




Fig 18: Publikimet e artikujve keqinformues në mediat sociale sipas fushave tematike (korrik 2023 - qershor 2024)

6. Institucionet dhe personalitetet më të përfolura

Edhe gjatë kësaj periudhe vjetore të monitorimit të gjendjes së çrregullimit informativ në Kosovë, institucionet e sigurisë janë përfolur më së shumti nga publikuesit e artikujve keqinformues që ndërlidhen me dinamikën e zhvillimeve të sigurisë dhe politikës në Kosovë.

Prej gjithsej 818 artikujve keqinformues të monitoruar nga "hibrid.info" për këtë periudhë, 129 prej tyre ose 16% kanë përfolur institucione dhe organizata të ndryshme të Kosovës ose edhe të huaja që ndërlidhen me zhvillimet në Kosovë. Prej këtij numri të përmbajtjeve keqinformuese (129) në të cilat janë përfolur institucionet, Forca e Sigurisë së Kosovës është përfolur më së shumti prej 33% të artikujve keqinformues për armatosjen, blerjen e pajisjeve të reja për FSK-në, fonde për FSK-në dhe tema të tjera në ndërlidhje me këtë institucion të sigurisë. Pothuajse të gjithë artikujt për FSK-në janë publikuar në gjuhën shqipe prej 95%, kurse pjesa tjetër në gjuhët tjera (angleze dhe serbe). Gjithashtu, sipas të dhënave monitoruese, rreth 90% e përmbajtjeve keqinformuese që përfojnë FSK-në janë shpërndarë në gjuhën shqipe nga publikues të ndryshëm në mediat sociale, kryesisht

nga llogari në TikTok (50%), faqe dhe media në Facebook (45%) dhe nga llogari e kanale tjera në media tjera sociale (Reddit dhe YouTube).

Institucioni i dytë më i përfolur është Policia e Kosovës nga 17% e publikimeve keqinformuese lidhur me zhvillimet në veri të Kosovës, pagat e policëve etj. Shumica e artikujve keqinformues që kanë përfolur Policinë e Kosovës janë publikuar në shqip nga publikues në mediat sociale prej 68%, kryesisht nga faqe, media dhe profile në Facebook dhe llogari në TikTok. Derisa mediat reale në gjuhën shqipe kishin shumë më pak publikime keqinformuese për Policinë e Kosovës (rreth 9%), mediat reale në gjuhën serbe, në anën tjetër, kishin më shumë publikime (rreth 18%), duke përfolur Policinë e Kosovës në kontekst të ngjarjeve për veriun e Kosovës.

Institucionet tjera të përfolura janë Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë (10%), misioni i KFOR-it në Kosovë (2%), Ushtria Çlirimtare e Kosovës (2%) etj.




Fig 19: Institucionet e përfolura nga publikimet me përmbajtje keqinformuese (korrik 2023 - qershor 2024)

Sa i përket personaliteteve të përfolura, nga gjithsej 818 përmbajtje keqinformuese që janë monitoruar për këtë periudhë vjetore, 248 prej tyre ose 30% kishin vënë theksin tek përfolja e personaliteteve publike dhe politike. Edhe gjatë kësaj periudhe, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, si personalitet politik, është përfolur më së shumti në raport me personalitete të tjera në ndërlidhje me tema politike dhe të sigurisë. Më shumë se gjysma e publikimeve keqinformuese që përfolën Kurtin janë në gjuhën shqipe të publikuara

nga mediat sociale (29%) dhe mediat reale në gjuhën shqipe (25%). Publikimet keqinformuese në shqip për Kurtin ndërlidhen me vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës për ndalimin e dinarit serb në Kosovë, armatosjen e FSK-së, dialogun Kosovë-Serbi, regjistrimin e popullsisë, rrëzimin e Qeverisë Kurti etj. Kurse, përmbajtjet tjera keqinformuese ndaj Kurtit ose 46% janë publikuar në gjuhën serbe nga mediat reale që kanë përfolur Kurtin për veriun e Kosovës, vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë, kërcënime për luftë etj.




Fig 20: Personalitetet e përfolura nga publikimet me përmbajtje keqinformuese (korrik 2023 - qershor 2024)

7. Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave/premtimeve

Prej muajit tetor 2023, platforma “hibrid.info” kontrollon dhe vlerëson deklaratat e zyrtarëve të lartë politikë dhe institucionalë, si dhe të figurave publike që kanë ndikim publik. Sipas metodologjisë së “hibrid.info”, vlerësimi i deklaratave ose premtimeve të zyrtarëve politikë e institucionalë dhe figurave publike bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve, të cilat shpjegohen si në vijim:

- Në kategorinë e vërtetësisë, vlerësohen ato deklaratat që përmbajnë thënie që lidhen me fakte objektive, saktësia e të cilave mund të përcaktohet me anë të verifikimit objektiv. Deklaratat e trajtuara në këtë kategori marrin vlerësimin si “deklaratë e pavërtetë”, “gjysmë e vërtetë”, apo edhe “deklaratë e vërtetë”.
- Kategoria e qëndrueshmërisë vlerëson qëndrimet subjektive të bartësve të funksioneve publike për çështje në fushën e punës dhe kompetencave të tyre, si dhe veprimet e tyre në lidhje me pikëpamjet e shprehura. Vlerësimi i qëndrueshmërisë jepet në bazë të një krahasimi në mes të pikëpamjeve aktuale dhe të deklaruara më parë publikisht të akterëve politikë. Nëse qëndrimet për një çështje nuk ndryshojnë gjatë angazhimit publik të personit të monitoruar, deklaratat e tilla vlerësohen si të “qëndrueshme”. Ndërsa, nëse ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në qëndrime, deklaratat e tilla vlerësohen si të “paqëndrueshme”.

- Përmbushja apo mbajtja e premtimeve, kryesisht ndërlidhet me ato parazgjedhore, të cilat monitorohen në nivelin qendror dhe atë lokal gjatë mandatit katërvjeçar. Vlerësimi në këtë kategori bëhet si “mbajtje e premtimit” (nëse ai mbahet), “mbajtje e pjeshme e premtimit” dhe “premtim i pambajtur” (nëse ai nuk mbahet).

Gjatë kësaj periudhe vjetore, ekipi i platformës “hibrid.info” ka monitoruar gjithsej pesë deklaratat dhe pesë premtime për çështje të ndryshme. Për periudhën përkatëse të monitorimit, kishte 4 premtime të pambajtura, 3 deklaratat të pavërteta (3), si dhe 1 deklaratë gjysmë të vërtetë, 1 deklaratë të paqëndrueshme dhe 1 mbajtje e pjeshme e premtimit nga zyrtarë të lartë shtetërorë, të cilat analizohen përmbledhtazi sipas të dhënave të paraqitura në Figurën 17.

Albin Kurti	Premtim i pambajtur	Politika	Investimet në Trepçë
Albin Kurti	Premtim i pambajtur	Sociale	Regjistrimi i popullsisë
Albin Kurti	Premtim i pambajtur	Infrastrukturë	Rregullimi i rrugës Prishtinë- Gjilan
Enver Dugolli	Premtim i pambajtur	Sociale	Ligji i Pagave
Artane Rizvanolli	Deklaratë e pavërtetë	Sociale	Pagat e minatorëve
Arben Vitia	Deklaratë e pavërtetë	Sociale	Vdekshmëria e foshnjave
Arben Vitia	Deklaratë e pavërtetë	Shëndetësi	Pagat e mjekëve
Xhelal Sveçla	Deklaratë gjysmë e vërtetë	Siguri	Pagat e policëve
Përparim Rama	Deklaratë e paqëndrueshme	Infrastrukturë	Projekti i ndërlidhjes së Arbërisë me Pallatin e Rinisë
Alban Zogaj	Mbajtje e pjeshme e premtimit	Sociale	Biçikletat në kryeqytet

Fig 21: Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave dhe premtimeve gjatë periudhës vjetore (tetor 2023 - qershor 2024)

2.7.1. Premtime të pambajtura

Sa i përket premtimeve të pambajtura, gjatë periudhës së monitoruar, kryeministri Albin Kurti kishte bërë tri premtime të cilat nuk i kishte mbajtur. Njëri premtim kishte të bënte me investime në ndërmarrjen publike “Trepça” gjatë zgjedhjeve lokale më 2021, kur Kurti kishte premtuar 70 milionë euro investime gjatë viteve 2022 dhe 2023, ndërsa nga verifikimet e “hibrid.info” ka rezultuar se gjatë këtyre dy viteve vlera e investimeve në “Trepça” ka qenë 20 milionë euro. Premtim tjetër i pambajtur nga shefi i ekzekutivit kosovar ndërlidhet me autostradën Prishtinë-Gjilan, se ajo do të përfundonte dhe inaugurohej më 2023, por që ishte vërtetuar se nuk ka njoftim zyrtar për hapjen e kësaj autostrade më 2023. Po ashtu, kryeministri Kurti kishte premtuar se regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të fillonte më 1 nëntor 2023, në bazë të një vendimi qeveritar dhe përmes një deklarimi të vet kryeministrit. Megjithatë, pas verifikimit të fakteve nga hybrid.info ishte vërtetuar se vendimi nuk u zbatua në kohën e parashikuar, por një periudhë të mëvonshme gjatë vitit 2024.

Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Enver Dugolli, në njërin nga debatet televizive në Kosovë, gjatë muajit shtator 2023, për temën e mos-ekzekutimit të shtesave të rrezikshmërisë për Policinë e Kosovës, ishte shprehur se nuk ka marrëveshje mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë për Punë të Brendshme për zgjidhjen e këtij problemi, duke premtuar se do të zgjidhet për dy-tre ditë. Pavarësisht premtimit të deputetit, kjo çështje nuk ishte zgjidhur në kohën e paralajmëruar nga Dugolli.

2.7.2. Deklarata të pavërteta

Në kuadër të deklaratave të pavërteta janë monitoruar disa deklarime të ministrave të Qeverisë së Kosovës për çështje sociale dhe shëndetësore. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, kishte bërë dy deklarime të pavërteta. Njëri për shkallën e vdekshmërisë së foshnjave në Kosovë prej rreth 7 promil, i cilësuar si i pavërtetë sepse kishte rënë ndesh me raporte të organizatave ndërkombëtare që konstatojnë të kundërtën. Deklarimi tjetër i pavërtetë i ministrit Vitia ndërlidhej me atë se mjekët kosovarë kanë ndër pagat më të larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sipas verifikimit të fakteve nga platforma “hibrid.info”, u vërtetua se në krahasim me Kosovë, vetëm mjekët në Serbi kanë paga më të ulëta.

Sa i përket pagave, edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kishte deklaruar se pagat e minatorëve të Trepçës, në bazë të marrëveshjes së arritur ndërmjet Sindikatës së Minatorëve dhe disa deputetëve, do të ekzekutohen ndërmjet datave 6 dhe 10 të çdo muaji. Por, pas verifikimit dhe hulumtimit për këtë çështje, ishte kuptuar se pavarësisht deklaratës së ministres, pagat e muajit tetor 2023 nuk ishin ekzekutuar deri më 27 nëntor 2023.

2.7.3. Deklaratë gjysmë e vërtetë

Pas sulmit terrorist në Banjë të Zveçanit, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ishte deklaruar se të ardhurat mesatare për pjesëtarët e Njësitit Special Intervenues të Policisë së Kosovës kalojnë shumën e 2,200 eurove gjatë vitit 2023. Në bazë të kontrollit të fakteve nga "hibrid.info", ky deklaram u cilësua si gjysmë e vërtetë sepse legjislacioni aktual për pagat e zyrtarëve publikë nuk parasheh pagë të tillë për pozitat brenda Policisë siç ka deklaruar Sveçla, si dhe, po ashtu, është kuptuar se pagesa e pretenduar ka përfshirë policët e angazhuar në veri të vendit si pasojë e orarit të zgjatur të punës.

2.7.4. Deklaratë e paqëndrueshme

Gjatë kësaj periudhë është monitoruar një deklaram e kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, e vlerësuar si e paqëndrueshme. Në shkurt të vitit 2024, Rama ka publikuar projektin që ndërlidh lagjen Arbëria me Pallatin e Rinisë dhe Hotelin Grand. Për këtë projekt, kreu i kryeqytetit, gjatë fushatës zgjedhore më 2021, pati premtuar se do të realizohej brenda tre viteve. Por, pas hulumtimit nga hybrid.info, janë gjetur dallime ndërmjet projektit të premtuar në fushatën e zgjedhjeve lokale të vitit 2021 dhe atij të prezantuar në muajin shkurt 2024.

2.7.5 Mbajtje e pjeshme e premtimit

Në këtë kategori të premtimeve, nënkryetari i Prishtinës, Alban Zogaj, në dhjetor të vitit 2023, kishte njoftuar për ardhjen e biçikletave të qytetit në Prishtinë. Zogaj kishte paralajmëruar montimin e stacioneve gjatë javëve në vijim, kurse sipas të njëjtit, biçikletat do të jenë të gatshme për përdorim, në pranverë. Por, pas kontrollit nga "hibrid.info" në muajin prill 2024, është vërtetuar se që nga ardhja e biçikletave dhe deri në datën e publikimit të kontrollit të fakteve nga "hibrid.info" (9 prill 2024), nuk ishte vërejtur asnjë rezultat konkret, që i bën ato në dispozicion për shfrytëzim nga qytetarët. Ky premtim është vlerësuar si mbajtje e pjeshme e premtimit bazuar në metodologjinë e punës mbi përmbushjen apo mbajtjen e premtimeve.

III. PËRMBLEDHJE KRAHASUESE E TË DHËNAVE TË ÇRREGULLIMIT INFORMATIV NË KOSOVË NDËRMJET DY PERIUDHAVE VJETORE

Ky seksion i raportit ka për qëllim të paraqes, në formë të përmbledhur dhe krahasuese, të dhënat empirike të grumbulluara përgjatë dy viteve të monitorimit të keqinformimit ose çrregullimit informativ në Kosovë. Platforma “hibrid.info” ka filluar publikimin e raporteve nga monitorimi ditor i përmbajtjeve keqinformuese në korrik të vitit 2022.

Për periudhën e parë vjetore korrik 2022 – qershor 2023, “hibrid.info” ka publikuar dy raporte gjashtëmujore[19], kurse për periudhën vijuese korrik 2023 – qershor 2024 do të publikohet ky raport vjetor. Rrjedhimisht, në këtë pjesë të raportit krahasohen të dhënat e të dyja periudhave vjetore për gjendjen e keqinformimit në Kosovë.

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Sa i përket kategorive të çrregullimit informativ, të dhënat janë pothuajse të njëjta mes dy periudhave vjetore, por me disa dallime mes tyre. Ngjashëm si në këtë periudhë vjetore, edhe në periudhën paraprake, kategoria “Clickbait” ishte e para (25.3%) dhe në vendin e dytë kategoria “Dezinformatë” (25%) me vetëm 0.3% dallim.

Dallimi thelbësor ndërmjet këtyre dy kategorive vlerësuese gjatë dy periudhave vjetore qëndron në atë se përqindja e publikimeve keqinformuese “Clickbait” dhe “Dezinformatë” në periudhën paraprake ishte më e lartë në krahasim me periudhën të cilën ky raport mbulon, në të cilën

vërehet se ka rënie të lehtë të publikimeve keqinformuese tek të dyja këto kategori si pasojë e më shumë përmbajtjeve keqinformuese në kategori të tjera vlerësuese, si “Lajm i rremë”, “Përmbajtje e paverifikuar”, “Mashttrim” etj. Publikimet në gjuhën shqipe nga publikuesit në mediat sociale, gjatë kësaj periudhe, nuk ishin të fokusuar vetëm në shpërndarje të dezinformatave (14%), por edhe tek lajmet e rreme (14%), përmbajtjet e paverifikuara (11%) dhe keqinformime të vlerësuara si mashttrim (10%). Ndërsa, në periudhën paraprake kishte më pak publikime keqinformuese në këto kategori sepse mediat sociale nuk ishin matur në periudhën korrik 2022 – dhjetor 2022.

[19] Raporti i parë monitorues për çrregullimin informativ në Kosovë për periudhën gjashtëmujore korrik-dhjetor 2022 gjendet këtu: <https://hibrid.info/crregullimi-informativ-ne-periudhen-e-dyte-te-vitit-2022/>. Raporti i dytë monitorues për çrregullimin informativ në Kosovë për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2023 gjendet këtu: <https://hibrid.info/prapa-ekraneve-raport-vjetor-per-gjendjen-e-crregullimit-informativ/>.

Publikuesit në mediat sociale kanë nisur të monitorohen nga platforma “hibrid.info” nga muaji janar 2023 dhe për pasojë gjatë periudhës së kaluar vjetore kishte më pak publikime në këto kategori, veçanërisht lajme të rreme, përmbajtje të paverifikuar dhe mashtrime, siç vërehet nga të dhënat e figurës së mëposhtme. Për më tepër, vërehet se publikuesit në mediat sociale publikojnë shumë më pak përmbajtje keqinformuese në kategorinë

“Clickbait” në krahasim me mediat reale (për më shumë lidhur me këtë, shih Figurën 12 të këtij raporti). Rritja e përmbajtjeve keqinformuese në këto kategori vlerësuese të çrregullimit informativ ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë edhe tek kategoritë “Clickbait” dhe “Dezinformatë” për të pasur rënie të lehtë për këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake.




Fig 22: Krahasimi i të dhënave të publikimeve keqinformuese sipas kategorive vlerësuese të çrregullimit informativ ndërmjet të dyja periudhave vjetore (2022-2023 dhe 2023-2024)

Temat e keqinformimit

Ndryshime të mëdha vërehen tek temat e keqinformimit që janë përdorur nga publikuesit për krijim të përmbajtjeve keqinformuese. Gjatë kësaj periudhe vjetore, tema kryesore e trajtuar ishte konflikti mes Izraelit dhe Hamasit, si pasojë e publikimeve të shumta për këtë konflikt të huaj nga publikuesit në gjuhën shqipe në mediat sociale, veçanërisht në

Facebook dhe TikTok. Kurse, në periudhën paraprake vjetore (2022-2023), ngjarjet në veriun e Kosovës ishte tema kryesore e keqinformimit, ndërkaq në periudhën 2023-2024, veriu është renditur tek në vendin e tretë.




Fig 23: Krahasimi i të dhënave për temat kryesore të keqinformimit ndërmjet të dyja periudhave vjetore (2022-2023 dhe 2023-2024)

Fushat e keqinformimit

Dallime të theksuara vërehen edhe tek fushat e keqinformimit. Derisa në këtë periudhë kanë mbizotëruar përmbajtjet keqinformuese në fushën e sigurisë, në periudhën paraprake në vendin e parë ishte fusha politike që duket se i kanë ndërruar vendet me njëra tjetrën ndërmjet dy periudhave vjetore. Kjo për shkak se

gjatë periudhës paraprake vjetore, keqinformimet në fushën e sigurisë ishin në vendin e tretë, kurse ato politike në periudhën e tanishme janë në vendin e tretë përkatësisht. Fusha sociale ka mbetur e pandryshuar në të dyja periudhat e monitorimit duke qenë në vendin e dytë me përqindje pothuajse të njëjtë.




Fig 24: Krahasimi i të dhënave për fushat kryesore të keqinformimit ndërmjet të dyja periudhave vjetore (2022-2023 dhe 2023-2024)

Llojet e publikuesve

Një nga gjetjet kryesore tek monitorimi i përmbajtjeve keqinformuese ndërlidhet me llojet e publikuesve që kanë krijuar dhe shpërndarë artikuj keqinformues. Në bazë të mostrës së përmbajtjeve keqinformuese të monitoruara nga "hibrid.info" për këtë periudhë vjetore, publikuesit në mediat sociale kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues. Kjo është hera e parë kur mbi gjysma e publikimeve keqinformuese janë krijuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale, në krahasim me mediat reale apo ato të dyshimta.

Për më tepër, ky është dallim kryesor me periudhën paraprake vjetore kur mediat reale kishin publikuar dukshëm më shumë përmbajtje keqinformuese në krahasim me mediat sociale. Megjithatë, në këtë rast është i nevojshëm shpjegimi metodologjik që platforma "hibrid.info" ka nisur matjen e publikuesve në mediat sociale prej muajit janar 2023 dhe rrjedhimisht të dhënat e periudhës paraprake për mediat sociale përfshijnë vetëm periudhën janar-qershor 2023, por jo edhe periudhën paraprak korrik-dhjetor 2022.




Fig 25: Krahasimi i të dhënave për llojet e publikuesve që kanë shpërndarë artikuj keqinformues ndërmjet të dyja periudhave vjetore (2022-2023 dhe 2023-2024)

Institucionet më të përfolura

Ngjashëm si në periudhën paraprake, edhe gjatë kësaj periudhe vjetore, institucionet e sektorit të sigurisë në Kosovë kanë mbizotëruar në diskursin e përmbajtjeve keqinformuese të monitoruara.

Në këtë drejtim, Forca e Sigurisë së Kosovës është më e përfolura, e cila pasohet nga Policia e Kosovës. Në krahasim me periudhën paraprake, kur Policia e Kosovës ishte në vendin e parë, siç vërehet në figurën e mëposhtme.




Fig 26: Krahasimi i të dhënave për institucionet e përfolura nga publikimet me përmbajtje keqinformuese ndërmjet të dyja periudhave vjetore (2022-2023 dhe 2023-2024)

Personalitetet më të përfolura

Edhe sa i përket personaliteteve më të përfolura gjatë kësaj periudhe vjetore, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, vazhdon të mbizotërojë në përmbajtjet e ndryshme keqinformuese. Kurti, edhe gjatë

periudhës paraprake vjetore, ishte më i përfoluri nga publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe dhe mediat reale në gjuhën serbe në përmbajtjet e tyre keqinformuese lidhur me zhvillimet në Kosovë.




Fig 23. Krahasimi i të dhënave për personalitetet e përfolura nga publikimet me përmbajtje keqinformuese ndërmjet të dyja periudhave vjetore (2022-2023 dhe 2023-2024)

IV. PRAKTIKA E KEQ(INFORMIMIT)

Çrregullimi informativ në Kosovë zhvillohet kryesisht në media sociale që krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje keqinformuese në mënyrë të qëllimshme apo të paqëllimshme. Në një kontekst të caktuar politik dhe në funksion të arritjes së përmbajtjeve të tilla tek lexuesit dhe audienca sa më e gjerë, mediat sociale janë të papenguara në shpërndarjen e çfarëdo informacioni me një shpejtësi marramendëse që nuk është parë më herët.

Dalja në sipërfaqe e mediave sociale, mundësitë për përhapje të informacionit dhe përdorimi masiv i tyre nga mediat, publikuesit dhe përdoruesit e ndryshëm, ka mundësuar që përmbajtjet keqinformuese, krahas lajmeve të sakta dhe informatave të konfirmuara, të arrijnë sa më shpejt tek lexuesit dhe përdoruesit e mediave sociale. Kjo ka nxitur krijimin e shumë mediave online në Kosovë në prodhimin dhe shpërndarjen e lajmeve të ndryshme, përfshirë edhe ato me përmbajtje keqinformuese.

Të dhënat e grumbulluara nga "hibrid.info" tregojnë se mediat online, përveç që kanë prezencë online përmes faqeve në internet, kanë prani aktive në mediat sociale. Media sociale me ndikimin më të madh në Kosovë është Facebook, në të cilën shpërndahen gjerësisht publikimet e mediave dhe operatorëve të tjerë online që publikojnë përmbajtje me karakter keqinformues, ndërsa edhe TikTok shfrytëzohet nga llogari për shpërndarje të materialeve të keqinformimit, por Twitter

dukshëm më pak.

Teknologjia e sotme mundëson publikimin dhe shpërndarjen e shpejtë dhe të lehtë të informacionit, por edhe përdoruesit dhe publiku i gjerë bien pre e çrregullimit informativ. Kjo vështirëson mbikëqyrjen, kontrollin dhe eventualisht sanksionimin e mediave dhe faqeve online që shpërndajnë publikime keqinformuese. Kjo është një nga sfidat kryesore të identifikuara në raportet e organizatave ndërkombëtare, të cilat kritikojnë për mangësi në legjislacionin aktual, i cili nuk rregullon veprimtarinë e mediave online. Që nga viti 2020 në Kosovë nuk shtypen më gazeta dhe publiku kosovar më së shumti informohet në hapësirën online, marrë parasysh shkallën e depërtimit të internetit në Kosovë, si dhe nga televizionet si formë tradicionale e informimit. Anketimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në tetor të vitit 2022, tregojnë për një depërtim pothuajse absolut të internetit në Kosovë prej 97.9%.

Sfida mbetet rregullimi i hapësirës digjitale dhe përballja me disa faqe dhe llogari në media sociale që publikojnë dezinformata. Kjo situatë bëhet më e ndërlikuar nga shpejtësia me të cilën përhapet informacioni në internet dhe nga natyra e medias sociale që lejon qasjen e shpejtë dhe të gjerë tek audienca. Përdoruesit e mediave sociale shpesh nuk kanë mjetet ose kohën për ta verifikuar saktësinë e informacionit që shohin, gjë që kontribuon në përhapjen e dezinformatave.

V. RREGULLIMI DHE VETËRREGULLIMI I MEDIAVE

Gjatë kësaj periudhe vjetore, çështja e rregullimit të mediave në Kosovë ka dominuar në diskursin publik në Kosovë nga komuniteti i mediave, shoqëria civile dhe përfaqësuesit politikë dhe institucionalë në vend. Mekanizmi për rregullimin e mediave në Kosovë është Komisioni i Pavarur për Media (KPM) si institucion kushtetues dhe ligjor. KPM-ja është organ i pavarur me kompetenca për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit, si dhe me Ligjin në fuqi për KPM-në[20] (Ligji Nr. 04/L-44 i miratuar më 2012), rregullon të drejtat, detyrimet, si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale[21], që nënkupton radiot dhe televizionet në Kosovë.

Megjithatë, deri më tani, mediat online nuk kanë qenë subjekt i rregullimit ligjor, as me Ligjin aktual të KPM-së dhe as me ndonjë ligj tjetër në Kosovë.[22] Bashkimi Evropian vazhdimisht ka kërkuar nga institucionet kosovare të ndryshojnë Ligjin në fuqi të KPM-së për të përfshirë në kuadër të kompetencave të KPM-së edhe rregullimin e mediave online audiovizuale, në pajtim me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audiovizuale. [23]

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin e ri për KPM-në në dhjetor të vitit 2023[24] dhe pas procedimit në Kuvend u miratua nga deputetët e Kuvendit të Kosovës në lexim të parë në muajin mars 2024[25] dhe në lexim të dytë katër muaj më vonë, në korrik të vitit 2024 nga Kuvendi i Kosovës.[26] Përmbajtja e këtij projektligji të hartuar nga Qeveria, para, gjatë dhe pas miratimit të tij, ka nxitur shumë debat tek komuniteti medial, shoqëria civile dhe organizata e institucione ndërkombëtare që kanë dhënë vërejte dhe kanë shprehur kundërshtime lidhur me pjesë të caktuara të projektligjit sa i përket fushës së rregullimit të mediave në Kosovë. Për më tepër, në projektligjin e miratuar thuhet tekstualisht se është “pjesërisht në përputhje me Direktivën (EU) 2010/13/EU për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale dhe Direktivën (EU) 2018/1808” duke nënkuptuar se nuk është harmonizuar në përputhshmëri të plotë me Direktivën përkatëse të BE-së.[27]

Vërejte dhe rekomandime serioze për përmbajtjen e projektligjit kishte shprehur edhe Këshilli i Evropës përmes një opinioni ligjor në maj të vitit 2024.[28] Sipas një analize të Forumit për Integritetin e Informacionit publikuar në muajin qershor

[20] Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media.

[21] Neni 3, Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media.

[22] Avdiu, P., & Osmani, S. (2023). *Prapa Ekraneve: Raport vjetor për gjendjen e rregullimit informativ*, f. 44. Prishtinë: ADS/hibrid.info.

[23] European Commission. (2023). *Kosovo 2023 Report*, f. 97. Brussels: European Commission.

[24] Uka, A. (27 dhjetor 2023). *Qeveria miraton projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave*. Kallxo.com

[25] Radio Evropa e Lirë. (7 mars 2024). *Kuvendi e miraton në lexim të parë Projektligjin për KPM-në*.

[26] Radio Evropa e Lirë. (11 korrik 2024). *Kuvendi miraton projektligjin e kontestueshëm për mediat*.

[27] Neni 1, Projektligji për KPM-në.

[28] Council of Europe. (2024). *Legal Opinion on the Draft Law on the Independent Media Commission of Kosovo*. LEX/FoE (2024)6, 24 May 2024.

2024, prej 12 rekomandimeve kryesore të Këshillit të Evropës, vetëm 2 prej tyre ishin trajtuar nga Komisioni përkatës parlamentar për media, kurse 10 rekomandime të tjera nuk ishin trajtuar fare.[29] Kjo nënkupton se shumica dërrmuese e rekomandimeve të Këshillit të Evropës ose 83% e tyre nuk ishin marrë parasysh para se projektligji të dërgohej në seancën e Kuvendit për votim në lexim të dytë.[30] Kjo është konfirmuar edhe nga përfaqësues të Këshillit të Evropës, sipas të cilëve projektligji në fjalë përmban dispozita problematike për dezinformim e përmbajtje të dëmshme, si dhe nuk janë përfshirë rekomandimet e Këshillit të Evropës në projektligj.[31]

Njohës të mediave, gazetarë dhe redaktorë të mediave kanë kritikuar se dhënia e kompetencës së rregullimit të mediave online tek KPM-ja me projektligjin e ri ka buruar edhe si rezultat i mungesës së angazhimit konkret e serioz të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), si mekanizëm vetërregullues i mediave online në Kosovë. Sipas tyre, komuniteti medial në Kosovë ka reaguar ndaj këtyre çështjeve vetëm atëherë kur Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë nismën për hartimin e Projektligjit për KPM-në që i vendosë mediat online nën përgjegjësinë e KPM-së.[32] Si zgjidhje ata kanë propozuar të ndiqen modele të vendeve të BE-së për vetërregullimin e mediave online që mund t'i përafrohen kontekstit të Kosovës në mënyrë që të shmangen ndërhyrje nga shteti ose politika sa i përket

fushëveprimtarisë së mediave online duke marrë parasysh se KPM-ja është institucion shtetëror dhe mund t'i ekspozohet ndikimit politik.[33]

Nga ana tjetër, në rrafshin praktik të funksionimit të mediave në Kosovës, qoftë televizioneve ose atyre online, një sfidë serioze është edhe ndërveprimi i tyre me aspektin digjital në kuadër të zhvillimeve të shpejta të teknologjisë, veçanërisht të mediave sociale (Facebook, TikTok etj.). Në këtë drejtim, përshtatja e mediave tradicionale me trendet e reja të hapësirës digjitale lëkundet në njërën anë mes mundësive që ofron hapësira digjitale për përfitime financiare të mediave në bazë të klikimeve, si dhe të ruajtjes së kualitetit dhe standardeve profesionale në krijimin dhe shpërndarjen e lajmeve për informim të drejtë, profesional dhe të paanshëm.[34] Njohës të mediave kosovare theksojnë rëndësinë e zhvillimit të planeve adekuate të biznesit nga ana e mediave dhe kritikojnë ato se nuk bëjnë planifikim të duhur për t'u përshtatur me nevojat e hapësirës digjitale, ndërsa kjo shfrytëzohet nga publikues të tjerë të dyshimtë për të shpërndarë lajme të ndryshme, veçanërisht në mediat sociale me qëllim rritjen e klikimeve dhe përfitime të tyre pavarësisht cilësisë së lajmit që shpërndajnë. Marrë parasysh këtë, ekspertë të mediave kanë rekomanduar që mediat në Kosovë që kanë për qëllim ruajtjen e profesionalizmit duhet ta rishikojnë mënyrën e plasimit dhe transmetimit të informacionit në mediat sociale.[35]

[29] Sbukner. (11 qershor 2024). Analizë e amandamenteve të projektligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

[30] Po aty.

[31] Redenica, M. (26 qershor 2024). Komisioneri i KiE-së për të Drejtat e Njeriut: Miratimi i Projektligjit për KPM-në do ta cenonte lirinë e medias. Koha.Net.

[32] Grupi i fokusit me njohës dhe ekspertë të mediave organizuar nga "hibrid.info". Prishtinë, 6 qershor 2024.

[33] Po aty.

[34] Po aty.

[35] Po aty.

Rekomandimet

Të shqyrtohet projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave në përputhje të plotë me Direktivën (EU) 2010/13/EU për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale dhe Direktivën (EU) 2018/1808, duke marrë parasysh rekomandimet kryesore të Këshillit të Evropës.

Rekomandohet që të ngriten kapacitetet profesionale të mediave në Kosovë përmes vendosjes së kritereve të detyrueshme për trajnime intensive dhe të vazhdueshme për gazetarët, me fokus në metodat dhe teknikat e identifikimit dhe zbulimit të përmbajtjeve keqinformuese, dezinformative dhe lajmeve të rreme. Po ashtu, është e domosdoshme që pronësia, transparenca dhe financimi i mediave të rregullohen në një formë apo tjetër.

Platformat për kontrollin e fakteve në Kosovë duhet të intensivikojnë aktivitetet e tyre në identifikimin e përmbajtjeve keqinformuese dhe të rreme nga mediat dhe publikuesit e ndryshëm. Kjo është e nevojshme për të rritur vetëdijen e lexuesve dhe përdoruesve të hapësirës online mbi rreziqet e dezinformative dhe lajmeve të rreme.

Kërkohet nga institucionet qeveritare, veçanërisht Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe mekanizmat përkatës, që urgjentisht të angazhohen për përfshirjen e lëndës së edukimit mediatik dhe digjital në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, duke parë se çrregullimi informativ është tashmë një realitet, i cili nuk do të zhduket shpejt.

Duhet të organizohen fushata informative, me përfshirjen e institucioneve rregulluese dhe vetërregulluese të mediave, mediave dhe shoqërisë civile, për edukimin medial të popullatës në dallimin e lajmeve të vërteta nga përmbajtjet keqinformuese, në mënyrë që palët dhe audienca e gjerë të kuptojnë rolin e këtyre mekanizmave.

Fjalorthi

CLICKBAIT

"Clickbait" vlerësohen ato përmbajtje informative titulli i të cilave është përgjithësisht dhe nuk bënë të ditur vendndodhjen e ngjarjes, kontekstin dhe relevancën. Artikuj të tillë synojnë të tërheqin vëmendjen e audiencës me tituj sensacionalë me pasojë çorientuese, që nuk e qartësojnë saktësisht përmbajtjen e artikullit. Titujt "clickbait" bëhen kryesisht për të tërhequr lexueshmëri në rastin e publikimeve mediatike dhe/ose për të fituar nga klikimet në rastet e publikimeve komerciale.

GABIMI

Vlerësimin "Gabim" e marrin përmbajtjet informative në të cilat, gjatë procesit të përpilimit apo publikimit, paraqiten gabime duke publikuar informacion të pasaktë (sidomos kur kemi të bëjmë me informacione në shifra) ose duke transmetuar lajme të pavërtetuara mirë, pa qëllimin e qartë të dezinformimit të publikut.

MASHTRIM

Vlerësimi "Mashttrim" u bëhet atyre përmbajtjeve informative të cilat manipulohen si në aspektin vizual (deepfake, cheapfake), zanor (audio) apo tekstual të përmbajtjes për të mashtruar audiencën. Zakonisht kjo formë e mashtrimit përdoret për të prodhuar përmbajtje të paqena dhe të manipuluar.

TEORI KONSPIRATIVE

Vlerësim si "Teori konspirative" marrin ato përmbajtje informative të cilat në vete përmbajnë një përshkrim të rremë ose të paverifikueshëm të një dukurie, ngjarje ose një personi, duke e paraqitur atë si pjesë ose rezultat të një plani të fshehtë ("komplot"). Ato paraqesin një seri pretendimesh, të paraqitura si fakte, midis të cilave vendosen marrëdhënie shkak-pasojë, pa ofruar ndonjë provë të besueshme.

PSEUDOSHKENCË

Vlerësim si "Pseudoshkencë" marrin ato përmbajtje informative që përpiqen të paraqesin disa mendime, qëndrime, vlera ose gjetje të marra nga një metodë jo-shkencore dhe ti paraqesin ato si zbulime shkencore ose fakte. Raporte të tilla shpesh keqinterpretojnë ose manipulojnë kërkimet shkencore ekzistuese, ose i referohen hulumtimeve që janë në kundërshtim me verifikimin shkencor dhe gjetjen e fakteve.

MANIPULIM I FAKTEVE

Vlerësimin si "Manipulim i fakteve" marrin ato përmbajtje informative që përdorin fakte të njohura si të sakta, por i interpretojnë ato në mënyrë të shtrembëruara. Këto raporte zakonisht përdorin informacion të saktë për të nxjerrë përfundime ose pretendime të pasakta, duke drejtuar kështu përfundimet e konsumatorëve të përmbajtjes së mediave në drejtim të gabuar në lidhje me kuptimin aktual të fakteve të paraqitura.

DEZINFORMATATA

Vlerësimin si "Dezinformatë" e merr ajo përmbajtje informative e cila në vete përmban një "miks" të burimeve të pasakta apo edhe attribute gjysmë të vërteta, e që krijohet dhe/apo shpërndahet me qëllim të paramenduar për të shkaktuar dëm. Prapa motivit të prodhuesve/shpërndarësve të përmbajtjeve dezinformuese qëndron arritja e një qëllimi politik, financiar, psikologjik apo social.

SPINI

Vlerësimi "Spin" i jepet një përmbajtjeje informative me të cilin autori përpiqet të largojë vëmendjen e publikut nga disa përmbajtje ose fakte të tjera që raportohen në media në atë kohë. Karakteristikë e raporteve të tilla në m të largojë vëmendjen, dhe e cila është e pafavorshme për disa akterë, kryesisht politikë.

LAJM I RREMË

Vlerësimin “Lajm i rremë” e marrin ato përmbajtje informative që janë tërësisht të sajura apo të cilat në vete përmbajnë pretendime ose informacione faktikisht të gabuara. Përmbajtja që vlerësohet si lajm i rremë mund të përcaktohet se është krijuar dhe shpërndarë me qëllim të dezinformimit të publikut, d.m.th., për të paraqitur një pretendim që është plotësisht i rremë si fakt.

PËRMBAJTJE E PAVERIFIKUAR

Vlerësimi “I pa verifikuar” u bëhet atyre përmbajtjeve informative që nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për të konfirmuar pretendimet e bëra në raport, dhe të cilat nuk kanë mundur të verifikohen për shkak të rrethanave të caktuara (shpejtësisë, mungesës së burimeve) gjatë publikimit të përmbajtjes.

SATIRA

Vlerësimi i “Satirës” përfshinë përmbajtjet informative të cilat përdorin mjetet letrare si talljen dhe ironinë për të interpretuar zhvillimet e ndryshme që ndodhin. Kjo në vetë nuk përbën problem përderisa bëhet e ditur se përmbajtja në fjalë është satirike apo publikuesi njihet si publikues satirik.

MEDIA REALE

Media reale janë ato që u dihet vendi i origjinës, që janë të regjistruara si entitete juridike, si biznese apo OJQ, që kanë të dhëna për dhe rreth aktivitetit të tyre siç është pronësia, menaxhmenti, impresumi, adresa, stafi dhe të tjera.

MEDIA SOCIALE

Mediat sociale përfshijnë llogarit, profilet, fun page, faqet zyrtare në Facebook, TikTok, Twitter etj.

PORTALE TË DYSHIMTA

Portale të dyshimta janë ato për të cilat mungojnë të dhënat për pronësinë, menaxhmentin, impresumin, adresën, stafin dhe të tjera, apo i kanë ato vetëm si të pjesshme.

PUBLIKIMET NË GJUHËN SHQIPE

Publikimet në gjuhën shqipe përfshijnë përmbajtjet e publikuara nga: i) mediat reale, ii) faqe dhe profile të ndryshme në mediat sociale dhe iii) portalet e dyshimta.

PUBLIKIMET NË GJUHËN SERBE

Publikimet në gjuhën serbe përfshijnë përmbajtjet e publikuara nga mediat reale dhe media sociale në gjuhën serbe që ndërliken me zhvillimet në Kosovë.

VËRTETËSIA E DEKLARATAVE


Në kategorinë e vërtetësisë, vlerësohen ato deklaratat që përmbajnë thënie që lidhen me fakte objektive, saktësia e të cilave mund të përcaktohet me anë të verifikimit objektiv. Deklaratat e trajtuara në këtë kategori marrin vlerësimin – deklaratë e pavërtetë, gjysmë e vërtetë, apo edhe deklaratë e vërtetë.

QËNDRUESHMËRIA E DEKLARATAVE

Vlerësimi i qëndrueshmërisë jepet në bazë të një krahasimi në mes të pikëpamjeve aktuale dhe të deklaruara më parë publikisht të akterëve politikë. Nëse qëndrimet për një çështje nuk ndryshojnë gjatë angazhimit publik të personit të monitoruar, deklaratat e tilla vlerësohen si të qëndrueshme. Ndërsa nëse ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në qëndrimet, deklaratat e tilla vlerësohen si të paqëndrueshme.

PËRMBUSHJA APO MBAJTJA E PREMTIMEVE

Përmbushja apo mbajtja e premtimeve, kryesisht ndërlidhet me ato parazgjedhore, të cilat monitorohen në nivelin qendror dhe atë lokal gjatë mandatit katër-vjeçar. Ky hulumtim bëhet kryesisht në kohën e fushatës parazgjedhore, ku figurat kryesore politike monitorohen, në mënyrë që të ketë kontroll të fakteve për atë që e thonë. Vlerësimi në këtë kategori bëhet – mbajte e premtimit (nëse ai mbahet), mbajte e pjeshme e premtimit dhe premtim jo i mbajtur (nëse ai nuk mbahet).



HIBRID.INFO

